



"Thash&Them" Suplementi për VIP-at
 Intervista e Elvana Gjatës:
 Prapaskenat te klipi "Gjaku im"
 ► Faqe 13-20

PARADA GAY

► Faqe 9

Ambasadori
 holandez: Ekrem
 Spahia, injorant

AKUZAT

► Faqe 10

Gjyqtari liron
 Shullazin në zyrën
 e tij: Nuk kishte armë

MYZAFER KORKUTI

► Faqe 22

Si e shkatërroi
 reforma Akademinë
 e Shkencave

[SHQIPTARJA.com]



LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi THASH&THEM

VITI II - NR. 111 E shtunë, 12-05-2012

EKSKLUZIVE/ Vendimi i Gjykatës së Apelit në shkurt 2012 ku flitet për planin e "Ceament"

VRASJA E PALESTINEZIT

1.5 mln euro për të eliminuar ortakët


Zbulohet tentativa e aksionerëve të fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë. Do të eliminonin njërin prej ortakëve në biznes. Denoncimi i të dënuarit Bashkim Zalla: George Jaha e të tjerë do të vrisnin aksionerin Charles Bouri

Lajmi

Aksionerët e fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë kishin në plan të eliminonin njërin prej ortakëve në biznes. Kështu pretendon Bashkim Zalla, njëri prej pjesëtarëve të familjes Zalla në Fushë-Krujë, i dënuar në shkurt 2012 me 4 muaj burg, për kërcënim ndaj aksionerit George Jaha, të kompanisë ku ishte drejtor Anwar Rizik, palestinezi 43-vjeçar i ekzekutuar tre ditë ditë më parë. Bashkimi thotë se kishte dijeni të plotë për planin e tyre për vrasjen e shtetasit Charles Bouri duke paguar plot 1.5 milionë euro për këtë vrasje.



Në foto: Fabrika e çimentos CEAMENT ALBANIA në Fushë-Krujë dhe faksimile vendimit të Gjykatës së Apelit në shkurt 2012 për shtetasin Bashkim Zalla



Koment



NGA AFRIM KRASNIQI

(Për) zgjedhja e Presidentit

Ditët e fundit procesi i zgjedhjeve të reja presidenciale mori një kthesë të re me nisjen e bisedimeve institucionale midis partive kryesore politike. Të gjithë takohen me të gjithë, edhe ata që kanë një projekt konkret, edhe ata që kanë një ambicje, edhe ata që kanë veto direkte apo indirekte politike në zgjedhje. Formalisht duket se po përsëritet pranvera politike e vitit 2002 dhe 2007. Si atëherë edhe tani ka një mazhorancë të brishtë ndaj shanseve reale për imponimin e emrit presidencial, ka një opozitë që pretendon të imponojë rregulla, krijetere dhe emra konkretë, ka një presion politik të dukshëm ndërkombëtar për një zgjedhje sa më konsultative siç edhe ka një ndjeshmëri të lartë publike.

Bashkë me postin e presidentit janë në lojë fati i disa institucioneve të rëndësishme kushtetuese, prestigji i demokracisë funksionale, provimi i maturisë për klasën politike, fati i mazhorancës qeverisëse dhe prologu i zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Ndërshe nga 1991, 1992 apo 1997 kur zgjedhjet presidenciale ishin formalitet për shumicën fituese, më 2002 dhe 2007 u kalua në terma të tjerë reference: më 2002 u zgjodh një emër konsensual me njohje publike, më 2007 një emër politik me kuotat më të larta të mbështetjes publike. Më 2012 pozicionet janë të skajshme: një palë që kërkon modelin e vitit 2002 (PS) dhe një palë tjetër që kërkon rikthim në modelet e viteve 1992 dhe 1997 (PD). Më 2002 e 2007 vendi nuk ndodhej pranë zgjedhjeve parlamentare dhe se mazhoranca në qeveri nuk kishte ndonjë problem numrash për të mbetur në pushtet, gjë që tani është e kundërt; zgjedhjet parlamentare janë pranë dhe mazhoranca mbahet... ► vijon në faqe 6

TIRANE

Një histori "mafioze" kërcënimesh, deri edhe me vdekje ka shoqëruar gjatë viteve të fundit aksionerët e kompanisë "Ceament Albania" dhe këto... ► vijon në faqe 2-3

- NDËR MEJTIME -

► Faqe 7



Vetëm nga një fjalë

NGA ARLINDA ÇAUSHOLLI



PROPOZIMI I LSI

► Faqe 4-5

Meta president? PD: Vendosi Berisha PS: Le të garojë

BRAKTISI EMISIONIN

TVSH: 25 mln lekë gjobë Shanajt

Regjisori u rebelua pas censurimit të dialogjeve të filmit "Pharmakon". Televizioni, padi në gjykatë



TIRANE

ELTON QYNO

Regjisori i njohur Mevlan Shanaj është paditur në Gjykatën e Tiranës, nga drejtuesit e Radio Televizionit Shqiptar. TVSH-ja i kërkon regjisorit dhe aktorit Shanaj dëmshpërblimin me një shumë prej 25 milion lekë... ► Faqe 11



Prokuroria ekspertim numrave që morën palestinezin

Ndërkohë që gjatë ditës së djeshme prokuroria e Tiranës ka urdhëruar ekspertimin e telefonit të 43-vjeçarit të ndjerë, Rizik si dhe u është kërkuar informacion kompanive celulare, lidhur me tabulatet telefonike. Ajo që shpresohet në këtë drejtim është gjetja e ndonjë prej numrave të pronarëve të tokës në celularin e viktimës, nga ku do

t'i orientonte anëtarët e grupit hetimor mbi një person të dyshuar si autor të kësaj ngjarje të rëndë. Ndërsa për sa i përket trupit të të ndjerit, burime pranë Institutit të Mjekësisë-Ligjore thanë se trupi Anwar Rizik është tërhequr nga vëllai i tij rreth orës 18:00 të mbrëmjes së djeshme, ku është nisur më pas në drejtim të

aerportit të Rinasit. Njëpërmyet një linje ajrore mësohet se ai ka udhëtuar nga Shqipëria në Turqi dhe prej këtu në drejtim të Palestinës, vend në të cilin do të varrosset trupi i pajetë i 43-vjeçarit. Ky i fundit u ekzekutua katër ditë më parë në derën e shtëpisë së tij, në të cilën ishte vendosur një granatë artizanale.

Dëshmia e gruas

Rizik mori kërcënime, banorët ankoheshin për tokën dhe tymrat

TIRANE


Palestinezi Anwar Rizik ka pasur gjithmonë shqetësime kur në ambientet e fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë zhvilloheshin protesta nga banorët e tokës mbi të cilën është ngritur fabrika. Këto shqetësime gjithmonë 43-vjeçari ja ka paraqitur bashkëshortes dhe familjarëve të tij, por në fakt asnjëherë nuk e ka kapur paniku për të marrë masa sigurie. Bashkëshortja e Palestinezit Anwar Rizik është marrë në pyetje nga anëtarët e grupit të hetimit ku në praninë edhe të një psikologe, Elda ka pohuar se Rizik shfaqte gjithnjë shqetësime në momentet kur banorët bënin protesta ose kur informohej lidhur me vënien e eksplozivëve afër fabrikës së çimentos. Gjatë



Anwar Rizik

dëshmisë së saj, Elda u ka treguar hetuesve se 43-vjeçari kishte marrë kërcënime të drejtpërdrejta, por në fakt në asnjë rast ai nuk i njihte kërcënuesit,

të cilët ankoheshin gjithmonë për zënieën e tokës nga fabrika si dhe tymrat e shumtë që dilnin prej saj. E pyetur nga specialistët e hetimit nëse kishte ndonjë rast kur pronarët e tokës kishin ardhur në shtëpi për të kërkuar lekët apo për tu sqaruar, ajo ka pohuar se në dijeninë e saj në asnjë rast në shtëpi nuk ka mbërritur asnjë prej pronarëve të tokës për të kërkuar lekët. Pas dëshmisë së bashkëshortes së 43-vjeçarit Anwar Rizik, në pyetje është marrë dhe vëllai i tij Ramiu. Ky i fundit në dëshminë e tij ka qëndruar në të njëjtën linjë me dëshmitë e tjera, duke pohuar se nga bisedat që bënte në internet më vëllain, në disa raste ai i është ankuar për konfliktet dhe problemet që kishte gjatë punës me disa prej banorëve të zonës ku ishte ndërtuar fabrika.




Në foto: Fabrika e çimentos SEAMENT ALBANIA në Fushë-Krujë

SMS-ja për aksionierin, Gjykata e Apelit e dënoi Bashkim Zallën me 4 muaj burg "Do njoftoj Aleksin për planet tuaja"

Mesazhi i banorit të fshatit Zallë për aksionerin: "Ti Xhorxh dhe Besimi i paguani me vra Çarlin nga 15 milionë euro, kështu më tha L.M. po për ju kush do paguajë se nuk i shpëtoni

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE
Nr.395 Akti Nr.214 Vendimi
V E N D I M
"Në emër të Republikës"
Gjykata e Apelit Tiranë, e përbërë prej:
Kryesues: Lefter JAHAJ
Anëtar: Genti SHALA
Anëtar: Metush SARACI
Mori në shqyrtim në Tiranë, në datë 29.02.2012, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, me pjesëmarrjen e prokurorit Shkelqim Kokona, çështjen penale nr.395 akti, datë 16.11.2011, që i përket:
TE PANDEHURIT: Bashkim Zalla, i biri i Hamditut dhe i Qamilës, dl.1957, lindur dhe banues në Zallë Fushë-Krujë, me adresim 4 klase, i martuar, me tre femije, i dënuar, mbrojtur kryesisht nga av.Mirela Rate.
AKUZUAR: Për veprën penale të "Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike", parashikuar nga neni 275 të k.penal.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr.144 akti datë 12.10.2011, ka vendosur:
Deklarimin fajtor të të pandehurit Bashkim Zalla për veprën penale të "Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike" dhe dënimin e tij në bazë të nenit 275 të k.penal me 6 muaj burgim.
Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale e dënon përfundimisht të pandehurin Bashkim Zalla me 4 muaj burgim. Vuajta e dënimit do t'i fillojë nga dita që vendimi të marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankimi i pandehuri, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit për faktin se: Meqenëse kjo veprë është me heqje dorë nga ankimi e shfrytëzohet këtë ankim për të m'u dhënë mundësia që ta shfrytëzojë këtë mundësi. Po kështu dënimi i dhënë është i rëndë

prandaj kërkoj ndryshimin e vendimit dhe dënim me gjobë pasi vepra është kundrvajtje penale.
GJYKATA E APELIT TIRANË pasi dëgjoi relatorin Lefter Jahaj, av. Mirela Rate që kërkoi ndryshimin e vendimit dhe caktimin e një dënimi më të butë siç është ai me gjobë, prokurorin që kërkoi lënieën në fuqi të vendimit dhe si shqyrtoi aktet e bisedoi çështjen në tërësi,
VERËN
Nga materialet e çështjes ka rezultuar se, prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë i ka dërguar për gjykim Gjykatës së Rrethit gjyqësor Krujë çështjen penale në ngarkim të të pandehurit Bashkim Zalla duke e akuzuar se ka kryer veprën penale të "Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike" të parashikuar nga neni 275 të k.penal. Hetimi gjyqësor i zhvilluar me procedurë të shkurtuar ka provuar se shtetasi Jorge Jeha ka marrë thirrje telefonike shqetësuese, mesazhe kërcënuese nga i pandehuri Bashkim Zalla. Thirrjet telefonike janë adresuar nga numri 068xxxx393 në përdorim të të pandehurit Bashkim Zalla në numrin në dispozicion të shtetasi George Jeha me adresuar nga numri 068xxxx283. Ndërmjet të tjerave në këtë numër në përdorim nga shtetasi George Jeha i është dërguar edhe një mesazh kërcënues nga i pandehuri Bashkim Zalla më datë 24.01.2011 me përmbajtje: "Ti Xhorxh dhe Besimi i paguani me vra Çarlin nga 15 milionë euro, kështu më tha L.M. po për ju kush do paguajë se nuk i shpëtoni dot krimeve tuaja fill pas Çarlit mendoni se do jetoni kam për tju q. rob të gjithëve.Ju vras,do njoftoj Aleksin për planet tuaja B.Zalla." Gjithashtu rezultoi se në numrin e disponuar nga kallzuesi George Jeha figuronte të regjistruara një seri thirrjesh telefonike, të cilat kanë qenë shqetësuese për ketë të fundit në vazhdimësi. Hetimi gjyqësor ka provuar se, arsyeja e thirrjeve telefonike dhe mesazheve shqetësuese e kërcënuese, ka të bëjë me faktin se shoqëria "Ceament Factory" Fushë-Krujë ka prerë pagesat mujore ndaj të pandehurit Bashkim Zalla për shkak të vështirësive financiare që po kalon. Këto pagesa janë dhënë për shkak të ndotjes që shkakton fabrika e Çimentos ndodhur në fshatin Zallë të rrethit Krujë. Sa sipër është provuar me thëniet e të pandehurit Bashkim Zalla, i cili ka pranuar autorësinë e këtyre thirrjeve dhe mesazheve si dhe me provat e ndodhura në fashikullin e gjykimit të ad-



Faksimile vendimit të Gjykatës së Apelit në shkurt 2012 për shtetasin Bashkim Zalla

ministruar si provë në seancë gjyqësore. Ndodhur në këto rrethana, me të drejtë gjykata e faktit ka konkluduar se, i pandehuri Bashkim Zalla ka konsumuar plotësisht veprën penale të "Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike", parashikuar nga neni 275 të k.penal. Edhe masa e lloji i dënimit për këtë veprë të kryer nga i pandehuri janë në përputhje me rreziqshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit të saj, i cili ndonëse është dënuar edhe një herë po për këtë veprë përsëri e ka kryer atë çka do të thotë për një vendosmëri të këtij të pandehuri për realizimin e qëllimeve të tij keqdashëse. Pretendimi i të pandehurit i bërë në kërkesën ankimore lidhur me të drejtën e të dëmtuarit për të hequr dorë Gjykata e Apelit Tiranë çmon se, nëse i dëmtuari do ta realizojë këtë të drejtë derisa nuk është dhënë vendimi përfundimtar nuk ka pengesë ligjore për ta realizuar këtë të drejtë. Lidhur me llojin e dënimit të dhënë nga gjykata e faktit, gjykata e apelit e konsideron të drejtë pasi i pandehuri po për këtë veprë është dënuar me burgim ç'ka do të thotë për një rreziqshmëri të madhe të të pandehurit. Sa sipër, Gjykata e Apelit Tiranë e çmon të drejtë vendimin e gjykatës së faktit dhe si të tillë e lë në fuqi.
PËR KËTO ARSYE:
Trupi Gjyqësor i Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të nenit 428/a të K.Pr.Penale,
VENDOSI
Lënieën në fuqi të vendimit Nr.144 akti datë 12.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Tirane me, 29.02.2012
A N E T A R A N E T K R Y E S U E S
Metush SARACI Genti SHALA Lefter JAHAJ
d.v. d.v.
Dërvtohet njësia me originalin
KANCELAR
Altin GJANA

ministruar si provë në seancë gjyqësore. Ndodhur në këto rrethana, me të drejtë gjykata e faktit ka konkluduar se, i pandehuri Bashkim Zalla ka konsumuar plotësisht veprën penale të "Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike", parashikuar nga neni 275 të k.penal. Edhe masa e lloji i dënimit për këtë veprë të kryer nga i pandehuri janë në përputhje me rreziqshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit të saj, i cili ndonëse është dënuar edhe një herë po për këtë veprë përsëri e ka kryer atë çka do të thotë për një vendosmëri të këtij të pandehuri për realizimin e qëllimeve të tij keqdashëse. Pretendimi i të pandehurit i bërë në kërkesën ankimore lidhur me të drejtën e të dëmtuarit për të hequr dorë Gjykata e Apelit Tiranë çmon se, nëse i dëmtuari do ta realizojë këtë të drejtë derisa nuk është dhënë vendimi përfundimtar nuk ka pengesë ligjore për ta realizuar këtë të drejtë. Lidhur me llojin e dënimit të dhënë nga gjykata e faktit, gjykata e apelit e konsideron të drejtë pasi i pandehuri po për këtë veprë është dënuar me burgim ç'ka do të thotë për një rreziqshmëri të madhe të të pandehurit. Sa sipër, Gjykata e Apelit Tiranë e çmon të drejtë vendimin e gjykatës së faktit dhe si të tillë e lë në fuqi.



Ceka: Unë president marr konsensusin e PD e PS, Nano shans zero

Neritan Ceka e sheh veten si një president që mund të marrë konsensusin e PD dhe të PS. "Në emrin tim në karrierën time, por jo në ambicien time, plotësohen disa nga kriteret e domosdoshme që të jetë dikush mbi partitë politike, që ka një përvojë të gjatë parlamentare, që ka bërë diçka për Shqipërinë dhe s'vjen direkt nga anonimiteti e të jetë dikush që përfaqëson diçka nga historia e Shqipërisë", tha Ceka.

Kandidat në 2007 përballë Topit dhe Nanos, Ceka shprehet se në kushtet aktuale kushtetuese, gjasat për një president konsensual janë pothuajse 0. "Presidenti konsensual në kushtet e tanishme është pothuajse i pamundur. Të jemi realist që është një president që duhet të dalë nga Kushtetuta e s'ka asnjë arsye që mund të imponojë një zgjidhje tjetër", tha Ceka. Po minimale, Ceka sheh dhe shanset që ish

kryeministri Nano të ulet në karrigen e Topit. "Në kuptimin kushtetues s'ka shumë shanse", vijoi ai. Por nisur nga përvoja e tij në politikë e në krah të Berishës, e në të njëjtën linjë me deklaratat e ambasadorit Arvizu, emrat aktualë që lakoheh për presidentë, do digjen për t'ia lënë vendin presidentit surprizë. "Natyrshik që kjo është mëse evidente, besoj që s'do jetë e papritura që do të ndodhi", përfund ai.

Ish-kreu demokrat: Meta President? Kryeministri, lider i procesit për koalicionin Presidenti, Shehu: Berisha vendos për tërë koalicionin

"Mendoj që në politikën e emancipuar nuk bëhen presione"

Lajmi

Ish-kryetari demokrat Tritan Shehu tek ka komentuar deklaratën e dalë nga LSI se Meta është një kandidat potencial për kreun e shtetit nuk ka munguar të shprehet se Berisha është lider i koalicionit që flet dhe në emër të tij për këtë proces. Njëherësh ai nënvizon faktin se politika e emancipuar nuk bën presione.



Ish-kryetari demokrat Tritan Shehu

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Deklarata e numrit dy të Lëvizjes Socialiste për Integrim Luan Rama se nuk përjashtojë mundësinë e një kandidimi nga ana e kreut të kësaj partie Ilir Meta për postin e Presidentit të Republikës ka shkaktuar jo pak reagime në spektrin e djathtë të politikës shqiptare. Ka qënë ish-kryetari i PD dhe Ministër i Jashtëm, deputeti Tritan Shehu ai që ka thënë për gazetën "Shqiptarja.com" se kryetari i koalicionit qeverisës është Sali Berisha dhe ai vendos në emër të koalicionit për këtë problem të rëndësishëm që ka të bëjë me zgjedhjen e kreut të ri të shtetit. "Unë nuk do të do bëj asnjë koment për një njeri të përcaktuar, por i qëndroj asaj që ka thënë zoti Berisha që PD do dalë me kandidatun e saj për President. I qëndroj kësaj deklaratë, pasi është thënë nga kreu i mazhorancës që e udhëheq këtë koalicion", ka deklaruar dje për gazetën Shehu, në përgjigje të interesimit për problemet që mund të shkaktojë një kandidim i Metës për në Presidencë. Njëherësh deputeti demokrat nuk sheh rrezik për koalicionin qeverisës në lidhje me këtë mundësi hyrje në garë të Metës për kreun e shtetit, sikurse deklaroi dje

Zbardhet pakti

Marrëveshja Rama-Meta, President jo nga PD, bashkim votash për reformat

■ ■ ■ TIRANE



Ilir Meta dhe Edi Rama

Takimi mes liderit socialist Edi Rama dhe kreut të LSI-së, Ilir Meta, në 1 maj në vilën e këtij të fundit, në Gjirin e Lalzit është finalizuar me një marrëveshje të rëndësishme, e cila pritet të ndikojë dukshëm në marrëdhëniet mes dy kundërshtarëve. "V.Plus" ka siguruar ekskluzivisht 4 pikat për të cilat është rënë dakord dhe që sipas burimeve pranë protagonistëve të takimit, janë diskutuar dhe në rrugë formale në takimin e dytë, tashmë publik, mes Ramës dhe Metës. Pavarësisht se lajmin për këtë takim dhe në mënyrë të përmblodhur bisedimet i ka publikuar në mënyrë ekskluzive gazeta "Shqiptarja.com". Marrëveshja përfshin zhvillime të rëndësishme politike, që nga zgjedhja e presidentit e deri te reforma parlamentare.

1. Palët bien dakord për zgjedhjen e një presidenti, jo nga PD.
2. PS dhe LSI do të bashkohen votat për heqjen e imunitetit, qoftë dhe duke bërë ndryshime në Kushtetutë, sipas rekomandimit të BE.
3. PS do të mbështesë kërkesën e LSI për

sekretari i përgjithshëm i LSI, Luan Rama. "Mendoj dhe këtë e them me forcë që koalicioni qeverisës ka një kryetar dhe ai është zoti Berisha. Pra për një gjë të tillë kaq të

rëndësishme, që është zgjedhja e kryetarit shtetit, është zoti Berisha që duhet të shprehet për tërë koalicionin. Dhe të gjithë anëtarët e koalicionit duhet të jenë koshientë që


aleanca ka një kryetar, të cilin i takon në mënyrë ekskluzive të jetë lideri i këtij procesi për koalicionin e djathtë qeverisës", është shprehur Shehu. I cili gjithsesi ka shprehur

bindjen e tij se aleati i majtë në qeverisje, LSI e drejtuar nga Ilir Meta është një parti serioze dhe që i respekton marrëveshjet në funksion të stabilitetit të vendit. "Unë jam i bindur që Meta është serioz dhe LSI parti serioze, e cila është përgjegjëse për rolin e saj të rëndësishëm që ka jo vetëm për koalicionin qeverisës por edhe për stabilitetin e vendit. Do të jetë luajale ndaj koalicionit, ashtu sikurse koalicioni, vetë PD dhe kryeministri Berisha kanë qënë shumë luajalë ndaj LSI në bashkëqeverisje", tha Shehu. Ish-numri një PD dhe ish-ministër i Jashtëm, nuk ka munguar të shprehë besimin e tij që LSI do të jetë në sinkron me PD dhe aleatët e tjerë të mazhorancës për të vendosur për çështje të rëndësishme, përfshirë dhe zgjedhjen e Presidentit. "Unë jam i bindur që LSI do të jetë e koordinuar me koalicionin dhe Berishën. Duke presopuzuar gjithnjë që Berisha është lider i koalicionit", tha Shehu. Për të cilin është shumë e rëndësishme të shmanget të gjitha llojet e presionit nga ana e aleatëve për çështjen e Presidentit apo të posteve të tjera në qeveri. "Mendoj që në politikën e emancipuar nuk bëhen presione. Janë marrëveshje për gjithçka dhe kanë vendosur që në nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëqeverisjen e deri ku shkon bashkëpunimi. Ne duhet të qëndrojmë të gjithë luajalë ndaj përcaktimit që kemi bërë dhe angazhimeve që kemi marrë që në fillim. Ndaj koalicioni është shumë i fortë sepse i qëndron luajalë këtyre virtyeteve që kemi marrë dhe vendosur që në fillim", tha Shehu. Për të cilin takimi i kreut të LSI Meta, aleate e PD në qeverisje, me kreun e PS Rama në opozitë s'përbën asnjë problem, pasi është në natyrën e politikës që të takohen dhe të dialogojnë. "Nuk merrem me takimet private, pasi gjithkush takon njerëz. Një politikan me ekspertizë nuk i ngatërron problemet", është shprehur Shehu.



Erjon Braçe:

"Presidenti, s'votoj të korruptuar"



Nënkryetari i grupit parlamentar të PS, Erjon Braçe është shprehur në adresën e tij në rrjetin social facebook se vendit i duhet një president i ndershëm, duke deklaruar njëherësh se ai nuk do të votojë asnjë kandidat të korruptuar për të qar dem votën e tij. "Dy gjera du të them: E para, pushteti pa moral-është ky që kemi, pushtet për të vjedhur. E dyta, na duhet një President i ndershëm. Unë kam vetëm një votë dhe nuk kam ndërmend ta jap për cilindo të korruptuar. Do të votoj për një njeri të ndershëm, burrë apo grua qoftë", ka qënë deklarata e djeshme e numrit dy të grupit parlamentar të PS Braçe. Deklarata ka ardhur pas daljes një nga një të kandidatëve të rinj për President.



OSBE, Uollfarth: Për Presidentin, dialog mes palëve politike

Kreu i Prezencës së OSBE në Tiranë, Eugen Uollfarth që nga Vlora ku ka qënë në një takim me kryebashkiakun Shpëtim Gjika është shprehur se e vlerëson dialogun politik për kreun e shtetit si dhe diskutimet për kandidatët e ndryshëm që kanë dalë. "Po zhvillohen diskutime për kandidatë dhe janë bërë publikë disa emra. Disa njerëz mund të kenë më shumë emra në mendje. Ky është

një proces shumë i rëndësishëm. Është shumë e rëndësishme që të përzgjidhen një ose disa persona të respektuar dhe në fund, njëri prej tyre të zgjidhet. Ky proces duhet udhëhequr nga shqiptarët. Për këtë arsye, e vlerësoj së tepërmi dialogun që po zhvillohet, në formatet e ndryshme midis personaliteteve shqiptare, përfshirë atë mes kryetarëve të partive", ka qënë deklarata e Uollfarth, dje për

mediat. I cili ka nënvizuar se nëse zhvillohet dialogu i duhur mes palëve, atëherë dhe produkti do të jetë i mirë. "E shoh si një dialog dinjitoz dhe të rëndësishëm, sepse, në fund të fundit, bëhet fjalë për një vendim të shqiptarëve për numrin një të shqiptarëve. Pra, po zhvillohet një proces i mirë, që, me shpresë, do të çojë në një rezultat të mirë", tha Uollfarth.

Vlerësim Blushit

Luan Rama: Ilir Meta për President LSI nuk e përjashton veten nga gara

TIRANE

Hartës politike për zgjedhjen e presidentit të ri i është shtuar edhe një tjetër element, që e bën më të komplikuar vijueshmërinë e procesit të nisur veçanërisht, kur bëhet fjalë për emra kandidatësh konkretë. Numri dy i LSI, Luan Rama ka hedhur dje në tregun politik propozimin e radhës që mund të jetë kryetari i LSI Ilir Meta kandidat potencial për kryetar shteti. Interesimit të gazetarëve se nëse Meta mund të jetë një kandidat konsensual për president, Luan Rama i është përgjigjur në mënyrë pohuese. "Pse jo, Ligji, Kushtetuta parashikon të drejtën dhe kriteret se kush mund të kandidojë për të qënë kryetari i shtetit. Në këtë pikëpamje, LSI nuk e përjashton veten nga e drejta që të



Luan Rama

kontribujë me të gjitha aftësitë dhe kapacitetet e veta, në të mirë të realizimit të zgjedhjes konsensuale të Presidentit. Gjithësesi çështja e emrit pastaj është një

çështje që do diskutohet pasi forumet politike të partisë të kenë gjykuar e vendosur në kohën kur do bëhet imediati përcaktimi kandidatit", ka qënë deklarata e sekretarit të Përgjithshëm të LSI, Luan Rama para mediave. Ai ka përsëritur dhe deklarata të anëtarit të kryesisë të PS, Ben Blushi që shprehu nevojën e një bashkëpunimi mes PS dhe LSI. "Ne jemi të gatshëm e i fitojmë të gjithë aktorët e faktorët politikë të vendit, të bashkojmë votat për Shqipërinë Europiane, të bashkojmë votat për integrimin europian të vendit, të bashkojmë votat për të realizuar reformën zgjedhore dhe tërësinë e reformave, që lidhen me procesin e integritimit europian. Ne do vazhdojmë të respektojmë dhe të jemi korrektë me përbushjen e paktit të bashkëqeverisjes me PD-në", tha Rama.

Anëtarja e kryesisë së PS: Po plotësoi kriteret, gjithkush kandidon

TIRANE

JAKIN MARENA

Meta President, Dade: Të drejtë të garojë cilido

"Deri më tani s'është diskutuar për emra"

Hyrja në lojën presidenziale e kreut të Lëvizjes Socialiste për Integrim Ilir Meta ka pëshpëlluar me të vërtetë politikën shqiptare, jo vetëm të spektrit të djathtë por dhe të atij të majtë. Kështu, ish-ministria e Jashtme, anëtarja e kryesisë dhe deputete e Partisë Socialiste Arta Dade ka deklaruar se gjithëcili ka të drejtë të garojë për postin e presidentit të Republikës nëse përbush kriteret kushtetuese dhe ligjore. Duke komentuar deklarata të Sekretarit të Përgjithshëm të LSI, Luan Rama se nuk përjashton mundësinë që kreu i kësaj partie të jetë kandidat për President, Dade nuk ka munguar të shprehet se tashmë nuk flitet për emra, duke iu referuar qëndrimit të kreut të PS, Edi Rama për këtë proces. "Pse jo mund të themi të gjithë. Ne nuk jemi ende të emrat për President të Republikës. Me sa e kam kuptuar nga letra dhe biseda e Ramës me Metën, kjo ka të bëjë më shumë me procesin, i cili edhe nga dokumenti i fundit i KE, Presidenti kërkohet të jetë gjithëpërfshirës në konsultim me të gjithë grupet e shoqërisë që janë të interesuar për këtë proces. Jam e prirur të besoj atë që thotë kryetari i PS që me askënd nuk është biseduar për të përcaktuar emra specifike sepse jemi ende në fazën kur procesi nuk ka nisur ende", ka qënë deklarata e deputetes so-



Arta Dade

cialiste Arta Dade dje për gazetën "Shqiptarja.com". Por këmbënguljes sonë në lidhje me emrat dhe mundësinë e kandidimit të këtyre emrave për postin e kryetarit të

shtetit, mes të cilëve dhe ai i Ilir Metës kreu i LSI-së, zyrtarja e lartë socialiste është shprehur se gjithkush ka të drejtën e aspirimit për një post të tillë të lartë, por duhet të jetë

BEN BLUSHI:


"Ky vend bëhet, koalicion me LSI për rrëzimin e Berishës"

Unë s'them asnjëherë që ky vend s'bëhet. Unë them sa e vështirë ka qënë për ne në pesëqind apo dymijë vjet ta ndryshojmë këtë vend. Por në asnjë rast s'them që s'bëhet. Them sa e vështirë, sa e kushtueshme ka qënë ta ndryshojmë, ta lëvizim pak përpara dhe kurdo që më jepet mundësia, përpiqem të them si mund ta ndryshojmë". Kjo ka qënë deklarata e Blushit, në rrjetin social Facebook, tekta ka argyumentuar lëvizjet dhe përpjekjet e tij politike për të qënë ndryshe. Ajo vjen vetëm në ditë pas deklarata të se është gati një koalicion me LSI për të rrëzuar Berishën. "Në qoftë se partitë na mbështesin për të rrëzuar qeverinë, do gëzojmë frytet e këtij rrëzimi. LSI e para, sepse të tillë janë numrat në parlament. Se çfarë ndodh nga dita që rrëzohet kjo qeveri, shkojmë në zgjedhje pas tre muajsh? Këtë do të preferoja unë" tha Blushi. Ai u shpreh i gatshëm për koalicion me LSI, duke e pranuar Metën dhe pse ishte ai njeriu që provokoi protestën tragjike të 21 janarit.

konform kriterëve të Kushtetutës dhe në orientimin e duhur të sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE. "Përsa i përket emrave që janë hedhur në media është e përcaktuar qartë

dhe sipas Kushtetutës, që cilido ka të drejtë të aspirojë për të kandiduar ose jo dhe për kreun e shtetit nëse plotësohen të gjitha kriteret. Pra sipas aktit themelart të shtetit dhe

sipas vizionit që një forcë e caktuar politike ka për rolin, detyrat e kriteret që duhet të përbushë personi që do zgjidhet si kryetar shteti. Kjo merr rëndësinë më të veçantë në momentet e tanishme edhe për shkak të sfidave që vendi ka përpara në axhendën evropiane", tha Dade dje për gazetën. Njëherësh anëtarja e kryesisë së Partisë Socialiste është shprehur e shqetësuar dhe për reformën zgjedhore e cila sipas saj duhet të realizohet përpara se të nisë sfida presidenciale, në mënyrë që qytetarët shqiptarë për herë të parë të kenë një ligj zgjedhor një vit para zgjedhjeve dhe jo të bërë në momentet e fundit. "Unë jam e mendimit, ashtu sikurse sikurse shumë politikanë të tjerë duke iu referuar dhe kërkesave të Bashkimit Evropian, që të ketë një angazhim të fortë për reformën zgjedhore e atë parlamentare. Këto dy reforma të rëndësishme duhet të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara nga Kuvendi, që do të thotë para fillimit të procesit dhe konsultimeve për zgjedhjen e kreut të shtetit", ka qënë deklarata e djeshme e Dades. Deklaratë kjo në të njëjtën linjë me atë çka është biseduar në takimim Rama-Meta në "Sheraton". Në të cilën është kërkuar me insistim që këto dy reforma të rëndësishme e të vendosura në 12 prioritetet e BE dhe heqja e imunitetit për deputetët, gjyqtarët e zyrtarët e lartë, të përfundojnë përpara 22 majit, kur fillon gara presidenciale.



Koment



NGA **AFRIM KRASNIQI**
vijen nga faqja 1

(Për) zgjedhja e Presidentit

...me 1-3 vota parlamentare të aleatëve politikë dytësorë.

Procesi i sivjetëm ka edhe disa tipare të reja. Së pari, publiku nuk ka rol; ai nuk mund të zgjedhë, nuk mund të pyetet dhe sondazhet publike ende flasin për mbështetje të emrave, që PD-PS I kanë përjashtuar paraprakisht nga propabiliteti i zgjedhjes. Pra, nuk po kërkohet një president që përputhet me pritjet dhe dëshirat qytetare, por një president ndryshe, nga kanalet e politikës dhe të jetë më pas simbol për të gjithë qytetarët!

Së dyti sistemi partiak nuk po prodhon garë presidenciale. Nuk ka garë sepse vetëm dy partitë e mëdha kanë nga 20 deputetë për të regjistruar një kandidat në garë, sepse vetë zgjedhja nuk bëhet përmes garës dhe se partitë e mëdha, sidomos PD, është aq larg natyrës demokratike të brendshme sa asnjë politikan brenda saj nuk mund ta thotë me zë të lartë ambicjen personale për postin e Presidentit. Mungesa e këtyre elementeve dhe premtimi që President të jetë "një nga figurat e shquara të PD", shprehje që rëndom përdoret për militantët e deri tek drejtohet e hipotekave, na bën të besojmë se më shumë se zgjedhje, por shkojnë drejt një përzgjedhje/emërimit pa garë të Presidentit.

Të treti ndryshim kushtetuese 2008 janë në provë dyfishë; sepse për herë të parë po zgjedhim një president me rregullat e reja dhe sepse koha tregoi se ato ndryshime ishin të nxituara e të gabuara. Palët menduan vetëm për veten e tyre, por sot shohim se sic dje nuk mjaftojnë 84 vota, sot nuk mjaftojnë as 71 vota për zgjedhjen e presidentit. Duhet me çdo kusht vota e dikujt tjetër, minimalisht të LSI dhe maksimalisht të PS.

Së katërti, procesi zgjedhor po bëhet "me rregulla ballkanike" përmes retorikës / agjendave personale dhe jo përmes akteve/sjelljeve institucionale. Nuk mbidhjet tryezja e koalicionit qeverisës, nuk mbidhet as ajo e opozitës, liderit kryesorë bisedojnë nëpër lokale, nuk ka platform dhe as propozime të shkruara, nuk shkohet më tej sesa kalkulimet personave të momentit dhe nuk ka ende një vizion të majtë e as të djathtë sesi duhet / se kush duhet të jetë Presidenti i ardhshëm. Pavarësisht këndvështrimeve, mund të thuhet se modeli Moisiu e Topi funk-

sionoi institucionalisht, por dy palët i anatemuan sa herë interesat e tyre ranë ndesh me frymën kushtetuese dhe mbi-partiake të aktivitetit presidencial. Dy partitë flasin për model të ri, por nuk ofrojnë asnjë të qartë se çfarë kuptojnë me këtë premtim, dhe pse janë kundër modeleve pozitive të deritanishme.

Së fundi, ka një diferencë të madhe midis asaj çfarë liderit politikë deklarojnë dhe asaj çfarë mendojnë apo që kryejnë në realitet. Mazhoranca krenohet në kancelaritë europiane me kthimin e opozitës dhe normalitetit parlamentar, opozita gjithashtu krenohet me kostumin e saj të ri integruar e dialogues, por dy palët ndahen qartë kur veprojnë në realpolitikë. Politika e muskujve dhe faktit të kryer ashtu si ajo e skenarëve me aleanca fluide ka përvojë



afatshkurtë dhe negative në Shqipëri. Gjithësesi kjo është ajo çfarë dy palët po ndjekin përsëri, duke e vendosur veten në konflikt me interesat publike dhe nevojën e madhe

që zgjedhjet presidenciale të japin një impuls pozitiv në procesin e vonuar të integrimit europian. Çfarë pritet të ndodhë pas 24 majit? Në atë datë të vitit 1944 u hodhën

bazat e një sistemi brutal, antidemokratik dhe njëpartak, mentalitetet dhe përvojat negative të se cilit ende dominojnë politikën e shoqërinë shqiptare. Më 2012 shpresa

është që të marrë udhë një periudhë e re, e ndryshme nga maji i Përmetit ku një palë mori gjitha pushtetet dhe ku vendin e institucioneve e zunë të fortët e partisë. Përvë këtë variant tjetër qytetar, të maturuar dhe pragmatist. Shanset reale dhe personalisht mendoj edhe zgjidhja më optimale në këto rrethana është që pas raundeve apo paradave të forcës në kafeneve apo konferenca shtyp, palët të detyrohen të bien dakord për një zgjidhje të pranshme të minutës së fundit. Shpresa është që kjo zgjidhje, në mos më e mira, të paktën të jetë sa më afër pritshmërive publike për njeriun që do të na përfaqësojë ne, shoqërinë dhe shtetin tonë në pesë vitet e ardhshme.

Koment

Pse kandidoj për Kryetar

NGA **EDMOND LEKA**

Ditën e hënës, në qytetin e Vlorës do të zhvillohen zgjedhjet për kryetarin e ri të këtij qyteti, pas largimit të detyruar nga ky post të deputetit të Vlorës Eltar Deda, pasi Asambleja e PS vendosi që deputetët të mos ishin edhe kryetarë partie, me përjashtim të Tiranës. Në garën për kreun e ri të PS së Vlorës konkurrojnë Gjergji Harizaj, anëtar i këshillit Bashkia, dhe Edmond Leka, nënkryetar i Bashkisë. Me kërkuesin e zotit Leka, shqiptarja.com, boton sot opinionin e tij për zgjedhjet në qytetin e Vlorës.

Partia Socialiste ka mbi 15 vjet që zhvillimohet si parti fituese në qytetin e Vlorës duke patur mbështetjen e gjerë të të gjithë opinionit, jo vetëm të anëtarëve dhe të simpatizantëve të saj. Kjo mbështetje nuk vjen thjesht prej tradizionit apo prej të ashtuquajturit "bastion", term me të cilin të djathtët përpiçen të justifikojnë humbet e tyre elektorale. Më shumë se për gjithçka, më shumë se për keqmenaxhimin, korupsionin, krizat ciklike, konfiktualitetin, misionin qeverisës, papërgjegjshmërinë, nepotizmin, mungesën e programeve të zhvillimit dhe paqes, më shumë se për gjithë bëmat dhe gjëmat që ka shkaktuar në këta shtatë vjet në pushtet PD, Vlorës është një qytet që beson se është qindra vjet më e mirë se kjo klikë që qeveris sot Shqipërinë. Historia e saj ka treguar që është e pakrahshme dhe në terrenin politik, duke i dhënë socialistëve dhe progresistëve atë mbështetje të gjerë dhe të plotë për të cilët në si PS e këtij qyteti ku 100 vjet më parë u formua shteti shqiptar,

mund të krenohemi me plot të drejtë. Sot gjendemi në vigjilje të një viti të rëndësishëm elektorale, 7 vjet që kur PD-ja qeveris Shqipërinë jo vetëm aksidentalisht por edhe me kuti të bllokuara në bodrumet e KQZ-së dhe vota të djegura buzë lumenjve, pas dy palë zgjedhës të maskuara si procese të vjedhura ditën për diell jo vetëm prej opozitës, por edhe nga faktori ndëkombëtar. Në këtë moment shumë të rëndësishëm për Rilindjen Shqiptare, solidariteti njerëzor dhe politik, i cili është në themel të filozofisë sonë si socialistë, është mëse i nevojshëm për gjithë qytetarët në Vlorë, por edhe në gjithë Shqipërinë. Me këtë frymë zhvillimi, solidariteti dhe shpallje të alternativës më të mirë për të ardhmen tonë dhe të femijve tanë, për zhvillimin e plotë të vendit dhe daljes njehere e përgjithmonë nga kriza ku e ka futur Berisha Shqipërinë, po zhvillohet dhe fushata për kreun e ri të PS-së në qytetin e Vlorës. Po zhvillohet një fushatë model, e cila po na bashkon më shumë me njerëzjetrin dhe nuk na ndan siç ëndërojnë kundërshtarët tanë, po na jep forcë dhe nuk po na dobëson në qëllimin tonë për t'i dhënë vendit një qeverisje të ndershme e të drejtë. Kjo është një fushatë që po na afron të gjithë bashkë me qytetarët për të zhvilluar demokracinë sa më shumë të jetë e mundur në rradhë të parë në shtëpinë tonë përpara se sëbashku me qytetarët të ndërtojmë shtëpinë tonë të madhe më 2013. Kjo është rilindja jonë për të ardhmen që meritojmë.

Politika qeverisëse në këto 7 vjet nuk ka arritur kurrë të bëhet përcuese e shqetësimeve të qytetarëve, të çojë përpara reformat e domosdoshme, integrimin dhe liberalizimin për të cilin çdo qytet i Shqipërisë ka nevojë. Pasi kjo është një politikë e ndarjes në

vend që të ishte një politikë e bashkimit. Kjo është një politikë që jo vetëm ndan qytetarët në të majtë dhe të djathtë, por edhe në klane, në krahina, në pushtetarë që kapardisen zyratë të shtetit si në pashallëqet personale, në disa që përfitojnë çdo gjë ndërsa shumica bart çdo ditë mbi kurritz varfërinë. Kjo është politika e abuzivizimit, e bllokut të zi në dorë, e shpërthimeve vdekjeprurëse dhe e qytetarëve të thjeshtë që vriten në mes të bulevardit kryesor të Tiranës ditën për diell. Kjo është politika e tarifat, e bllokimit të gjithë vijës bregdetare pasi kryeministri e sheh detin si liqen personal ku mund të shëtisë i vetëm me jahtin qeveritar dhe jo si mundësi e madhe ekonomike për të ndihmuar dhjetëramijëra familje që nuk mund të ngrysin dot ditët e tyre të mundimshme me gënjeshtrat më të pabesueshme se ne jemi ekonomikisht vetëm një hap larg Gjermanisë. Vlonjatët e shkodoranët, transit, qorçarët, dibranët dhe gjithë shqiptarët nuk e meritojnë këtë. Shqiptarët janë tre milion burra e gra që çdo ditë stërmundohen për të mbijetuar. Shqiptarët janë sipërmarrës me ide dhe kurajo për të investuar çdo qindarkë në rrugën për zhvillim dhe cilësi, por megjithëse qeveria ju ka zënë pritë, çdo ditë dhe orë ata punojnë në projektet tek të cilat besojnë. Shqiptarët janë djem dhe vajza që studiojnë dhe investojnë tek vetvetja, por me trishtim vërejmë se diplomat që pushteti shpërndan me lek në dorë vlejnë më shumë se munda i tyre për t'u shpërblyer si njerëz të ndershëm. Shqiptarët janë mësues të shkollave mizerabel, që megjithë pagesat të qytetarëve, të çojë përpara reformat e domosdoshme, integrimin dhe liberalizimin për të cilin çdo qytet i Shqipërisë ka nevojë. Pasi kjo është një politikë e ndarjes në

Evpropës duke nisur nga e para jetën e tyre pikërisht sepse në atdheun e tyre politika ju kishte marrë jetën e dhënë nga Zoti. Shqiptarët janë njerëzit që qëndrojnë të fortë dhe me dinjitet duke bërë ndoshta njëmijë sakrificat për familjet e tyre, por duke mos hequr asnjehere dorë nga ndershmeria, respekti ndaj ligjit, mikëpritja dhe solidariteti për atë që është më shumë në nevojë. Ky mund, këto shpresa, kjo bujari nuk meritojnë të zhduken në betejën e britmave të politikës së konfliktit. Shqipëria nuk meriton të shkatërronhet kështu nga një klikë që bllokoi si pakicë këtë vend.

Partia Socialiste është këtu për ta ndryshuar një herë e mire këtë realitet të trishtë. PS-ja është promotore e një Rilindje të madhe e cila do të shërbejë për ta ridashur politikën duke e ndryshuar përfundimisht atë. Ne nuk duam thjesht të ndryshojmë një qeveri me një tjetër por ne ofrojmë të ndryshojmë mentalitetin e atij që qeveris. Ne nuk do të vijmë në pushtet thjesht për rrotacion, por do të jemi aty për ta ndryshuar më së fundi këtë vend të mrekullueshëm. Ne nuk kandidojmë thjesht për të patur poste, por që sëbashku të bëjmë me të mirën. Ne, socialistët dhe progresistët do ta ndryshojmë sëbashku Vlorën dhe gjithë Shqipërinë me qëllim që nesër femijët tanë të thonë me krenari: "bënë atë që duhej, menduan për ne". Me këtë qëllim dhe bindje ne socialistët vlonjatë por edhe ata të gjithë Shqipërisë hyjmë në këtë vit të rëndësishëm elektorale. Na përket ne që këto shpresa ti materializojmë, të shpallim më të mirën për ne dhe për gjithë qytetarët. Prandaj në këtë optikë ne jemi të gjithë bashkë që të mendojmë jo vetëm për Partinë e dikujt por për Shqipërinë e përbashkët.

*Kandidat për kryetar të PS në Vlorë



Lëvizja Mjaft! padi Parlamentit për mungesë transparence

Lëvizja Mjaft! ka vendosur të padisë Parlamentin shqiptar për mungesë transparence. Ajo ka ndërmend "t'i drejtohet gjykatës për të garantuar zbatimin e ligjit, lidhur me kërkesat që kjo organizatë i ka drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për informacion zyrtar. Ky veprim pason mungesën e përgjigjes nga ana e Kuvendit ndaj gjashtë kërkesave për

informacion zyrtar që Lëvizja ka depozituar pranë këtij institucioni", sqarohet në një komunikatë për shtyp. "Kërkesat për informacion vijnë në kuadër të nismës për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve shtetërore përkundrejt qytetarëve, iniciative kjo e mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për

Shqipërinë, Soros", saktësoi Mjaft! ajo deklaroi në 5 dhjetor të vitit të kaluar ka dërguar 6 kërkesa zyrtare Kuvendit "me objekt marrje informacioni për buxhetin faktik dhe atë të detajuar të institucionit për vitin 2009 dhe 2010, për auditin e brendshëm si edhe për tenderin publik për mobilimin dhe rikonstrukcionin e sallës së seancës plenare.



Berisha shpërblen me diploma deputetët e tij

Dy deputetë, juristë për një vit tek Kristal

Universiteti u hap me vendim të Berishës

TIRANE

Lajmi

Pas diplomimit në mënyrë flagrante të "Bossi", skandali i diplomimit në kohë rekord, duke mos ju nështruar testimit dhe marrjes së njohurive të shtrira ndër vite, ka infektuar edhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Në një vit ata diplomohen për t'i shërbyer Kuvendit

Ka mjaftuar vetëm një vit dy ligjvënësve tanë për të marrë njohuri mbi jurisprudencën edhe të testohen për këto njohuri. Skandali vijon të thellohet me emra konkret të deputetëve, çka vë në rrezik njohuritë e tyre, por edhe pikëpyetjen pse e kanë kërkuar diplomën në këtë kohë afatshkurtër. Duke iu referuar të dhënave që vetë deputetët kanë prezantuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe po ti referohemi historikut të universitetit ku ata kanë marrë diplomën, arrijmë në përfundimin se ata nuk e kanë kryer ciklin shkollor, qoftë edhe në mënyrë formale. Gazeta "Idea" ka verifikuar se universiteti Kristal i ka hapur dyert për herë të parë në Dhjetor 2005. Ky universitet mori licencën nga qeveria, pak muaj pasi në pushtet kishte ardhur PD dhe kryeministër ishte bërë Sali Berisha. Studentët e parë pranë regjistruar në Dhjetor 2005 dhe në Qershor 2006 është zhvilluar sezoni i parë i provimeve në këtë universitet, në degët Farmaci, Stomatologji dhe Juridiki. Sipas deklaratimit të deputetit Çota, ai është diplomuar në vitin 2006, pra në gjysmëvitin e parë shkollor të këtij universiteti. Ndërsa deputeti Hasa, rezultoi të ketë ndjekur fakultetin në dy vitet shkollorë, 2005-2006, 2006-2007, ose më saktë në një vit e gjysmë, kohë gjatë të cilës ai ka qenë në detyrën e kryetarit të bashkisë së Peqinit. Kjo do të thotë se ai, në rastin më të mirë, duhet ka qenë ndër 80 studentët e parë që e nisën mësimin në vitin 2006, afërsisht katë të qarta e parë e studentëve që janë regjistruar në këtë universitet në degën Juridiki. Ai është diplomuar pra për dy vjet(një vit e gjysmë), edhe pse skema mbi të cilën funksionon ky universitet është ajo sipas kartës së Bolonjës,

3+2, pra duhen tre vite për të përfunduar diplomën e nivelit të parë. Këtu bie edhe hipoteza që provimet, mund të jenë kryer në mënyrë të përshejtuar, siç mund të ndodhë m studentët të shkëlqyer që edhe pse në vitin e parë, mund tu bashkohen në provime studentëve të viti të dytë ose të tretë, pasi ky ka qenë kursi i parë. Pra pyetja që mbetet pa përgjigje tash-

më është: Si i morën diplomat deputetët Çota dhe Hasa? Dhe kësaj pyetje mund t'i përgjigjet në mënyrë zyrtare vetëm grupi i hetimit të prokurorisë që ka nisur një hetim në këtë universitet, i cili nuk duhet të mjaftohet vetëm me verifikimin e rasti Bossi, por edhe të shumë studentëve shqiptarë. Një hetim ka nisur edhe Ministria e Arsimit, por nga ky in-

DEPUTETËT E DIPLOMUAR

- Skënder Hasa PS
- Bedri Hoxha PD
- Ndue Paluca PD
- Rrahim Çota PD
- Artan Gaçi PS

stitucion asnjë e vërtetë nuk do të dalë. Kjo, pasi vetë ish Ministri i Arsimit Genc Pollo dhe ish- këshilltari i kryeministrit për Arsimin, sot ministër, Myqerem Tafaj, kanë qenë tërësisht në dijeni të manipulimeve që bëheshin me regjistrimet fikrive në këtë universitet.



- NDËR MEJTIME -
NGA ARLINDA ÇAUSHOLLI

Vetëm nga një fjalë

Dëgjo! Merre pak filanin, dhe thuaj që...Kështu filloi biseda ime e parë e mëngjesit dje. Më saktë ishte bisedë telefonike. Do dëgjoja se s'bën se nuk kisha nga t'ia mbaja, për sa kohë unë dhe zotëria nga ana tjetër e receptorit kishim mjet komunikimi telefonin.

E mendimet tërhoqën njëri-tjetrin. Mbasa kur bashkëbiseduesin e ke përballë, ato ngjytr disi agresive të fjalës "dëgjo" shpërndahen në figurën e tij dhe sikur fashiten ca. Dhe për momentin nuk i jep rëndësi. Por çfarë ndodh realisht?

Kjo formë imponuese e fillimit të bisedës, që realisht më ngjan me një hu të rëndë, i drejtuar pjerrtazi ndaj një kundërshtari betejash kalorsiake, është një formë komunikimi që krijon hendek që në minutat e para. Dhe si pasojë, dashamirësia me të cilën ne përgatitem për bisedë ngrin. Dhe bashkë me të edhe komunikimi. Bashkë me komunikimin, edhe mendja. Bashkë me mendjen, edhe ritmi ynë i brendshëm. E mori lumi...

Sa herë jemi ndërjerë kështu? Qindra herë. Dhe jemi shumë. Dhe prapë i përdorim. Mbasa, na bën të ndihemi mirë për momentin sepse e marrim njëfarë pushteti pa na e dhënë njëri. Dhe lezetoni ai i shkallitë pushtet dhe pse pakminutësh. Rrit vetëbesimin? Mendoj se jo. Krijon formën më amorfë të të qënurit, të të jetuarit, të afrimit me njerëzit që diktohet nga një komunikim jo fort etik.

Por prapë, nuk është vetëm kjo. Kjo lloj qasjeje, tërheq efektin merimangë me një shpejtësi të habitshme, sepse njerëzit me të cilët komunikojmë 24 orë në ditë, në mënyrë të pavetëdijshme do të të përgjigjen me të njëjtin tonalitet të rënduar - krejt i panevojshëm - dhe për pasojë, energjia e shpenzuar nga të dy palët nuk është aspak pozitive. A mund të mendohet të bëhet diçka e mirë me energji negative? E vështirë. E kundërshtojnë njëra-tjetër. Për më tepër, pasojat do të ishin të pakthyeshme, duke filluar nga negociatat, intervistat, raportet dhe deri tek bisedat e thjeshta me vaditësit aq të mirë të luleve që na vijnë pa zhurmë nëpër zra.

Mendoj se një bisedë duhet të "gurgullojë" që të ketë efekt. Të jem e sinqertë, muzikaliteti i kësaj fjalë më plëqen shumë. Më jep idenë e entuziazmit, esencjal për komunikimin mes njëri-tjetrit, më jep idenë e rrjedhshmërisë, një ndër format më bindëse të prezantimit dhe e fundit...më injekton një optimizëm të shëndetshëm...që gjërat do të shkojnë mirë.

Dhe bën ndryshimin. Vetëm nga një fjalë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES

Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 2/223 10, e-mail: info@Durres.gov.al

"Ne zbatim të Nenit 7 dhe 44 të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligji nr.7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes se Republikes se Shqiperise" i ndryshuar, Ligjin nr. 9840 date 10.12.2007 "Per ratifikimin e Marrveshjes kuader ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Komisionit te Komunitetit Europian per rregullat e bashkepunimit per asistencen per Shqiperine ne kuader te zbatimit te instrumentit para aderimit IPA, Ligjit nr.10152 date 28.09.2009 "Per ratifikimin e Marrveshjes se Financimit ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Komisionit te Komuniteteve Europiane per Progarmin e Bashkepunimit nderkufitar Adriatik te instrumentit para aderimit IPA Komponenti II- Bashkepunimi Nderkufitar per Shqiperine" dhe Marrveshjes se bashkepunimit "Partnership Agreement" nr. 049 2009 midis Partnerit Lider (Mesagne (Brindizi) Itali) dhe Partnerve perfitues (Bashkia Durres FB6) dhe Urderhit te Kryetarit te Bashkise nr.61 date 07.05.2012.,

BASHKIA DURRES SHPALL KONKURS TE HAPUR

Bashkia Durres shpall Konkurs te hapur per perzgjedhjen e nje eksperti ne fushen e agrokultures dhe politikave agrare, ekspert i cili do te kontraktohet nga Bashkia Durres me kohe te pjeshme ne emer te projektit TURGRATE 2 per nje afat kohor te percaktuar ne projekt sipas procedurave te vleresimit qe percaktohen nga "Kodi i Punes" i Republikes se Shqiperise dhe kriteret e percaktuara ne "Manualin e menaxhimit dhe kontrollit te programit". Te gjitha te interesuarit jane te lutur te terheqin dokumentacionin e konkurimit duke filluar nga data 14.05.2012 ne "Njesine e Menaxhimit te Projektit TURGRATE 2" ne Drejtorine e Politikave te Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit prane Bashkise Durres ne adr. Lagjia Nr.3, Sheshi "Liria" Durres. Afati i fundit i dorezimit te dokumentacionit eshte data 08.06.2012. Dorezimi do te behet prane Komisionit te Vleresimit me date 08.06.2012, ora 10.00 prane Bashkise Durres ne adresen e mesiperme. Per cdo hollesi e sqarime te metejshme kontaktoni me Drejtorine e Politikave te Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ne Bashkine Durres".



Kryesia e grupit të PS: PD bllokon reformën zgjedhore te verifikimi

Është mbledhur dje paradi kryesia e grupit parlamentar të PS e cila ka marrë në analizë veprimtarinë e një jave të deputetëve socialistë dhe axhendën e javës së ardhshme. Është diskutuar në lidhje me interpelancat dhe debatet ku kryetari Rama s'ka munguar të vlerësojë përballjen e fortë me deputetët e mazhorancës në Kuvend dhe me ministrat, ndërkohë që ditën e djeshme një ndër shqetësimet e forta ka qënë

bllokimi i reformës zgjedhore nga ana PD. Teksa ka informuar kryesinë e grupit bashkëkryetari i komisionit për reformën zgjedhore Damian Gjiku, Rama dhe anëtarët e kryesisë së grupit kanë evidentuar arësyen e bllokimit të reformës. Pika në të cilën ka mbetur Reforma zgjedhore mes PD e PS ka qënë rasti kur ndërpritet energjia e mjeti i verifikimit të kartave e dokumenteve të identifikimit nuk

funksionon. Sipas PS, mazhoranca s'pranon që në rastet kur s'ka energji e nuk mund të verifikohet karta me instrumentin e përcaktuar administrata zgjedhore e KQZ të kenë të drejtë të rishikojnë materialet zgjedhore. PS këmbëngul që në këtë rast duhet të verifikohet me patjetër në KQZ numri i pasaportave apo kartave të identitetit. Pikërisht këtu ka mbetur reforma, e cila duhet të zhbllokohet.

Fushata një mujore për kreun e të rinjve socialistë, përballja

ELISA SPIOPALI

Gara për FRESH, dje 6 kandidatët në Korçë

Gara me model amerikan, platformat në 36 rrethe

"Duhet të merremi me politikë"



Të rinjtë shqiptarë përballen në çdo hap, çdo ditë dhe kudo me një sistem ekonomik, arsimor dhe social të mbrapshtë. Të rinjtë shqiptarë përballen në çdo hap, çdo ditë dhe kudo me një sistem ekonomik, arsimor dhe social të mbrapshtë. S'ka punë, s'ka perspektive, s'ka meritokraci, s'ka konkurrencë të lirë, servilizmi ka zënë vendin e ndershmërisë, nepotizmi vendin e meritës, mediokritetia vendin e talentit, kokëulja vendin e krenarisë, konformizimi vendin e qëndrësës". Kjo ka qënë deklarata e Spiropalit. Teksa ka nënvizuar se "ne kemi të gjitha arsyet për t'u marrë me politikë".

Lajmi
Të gjashtë kandidatët, të gjithë bashkë kanë filluar fushatën për zgjedhjen në krye të FRESH në qytetin e Korçës ku kanë shpallur platformat e tyre për të thithur votat e bazës e për të pasur mbështetjen e mjaftueshme që më 12 qershor në kongres të marrin fitoren.

TIRANE
JAKIN MARENA



Janë vetëm gjashtë të rinj, me ëndrra të forta për të kontribuar për vendin e tyre, për partinë në të cilën aderojnë dhe në veçanti për bashkëmoshatarët e tyre. Të përzgjedhur mes shumë e shumë të rinjve, dhe në përzgjedhjen e fundit në kryesinë e Partisë Socialiste mes 22 kandidatëve për të marrë drejtimin e organizatës rinore partiake më me traditë në vend FRESH, kanë nisur një fushatë të fortë prezantimi të alternativës së tyre drejtuese dhe të platformës për të ardhmen e FRESH në 36 rrethet e vendit. Gjashtë të rinj, të cilët janë vërtetë me ëndrra të forta, tekta lexon atë çfarë kanë shkruar dhe çfarë kanë prezantuar përpara bashkëmoshatarëve të tyre të rinjtë socialistë. Ata janë Elisa Spiropali, drejtuesja e komanduar e FRESH, Artur Micko, Erlis Hoxha, Joleza Koka, Juxhin Çela dhe Maria Myrindinas, të cilët të gjithë bashkë kanë startuar dje në qytetin e Korçës, qytetin e serenatave dhe të kulturës për të shpallur platformën e tyre, si për të treguar se fushata e tyre do të jetë e kulturuar. Një model amerikan i shpalljes së fushatës së zgjedhjes së kryetarit të ri të FRESH për një muaj rresht në të 36 rrethe e vendit për të ardhur më pas në Tiranë dhe më 12 qershor do të zhvillohet Kongresi Kombëtar i FRESH-it, ku do të zgjidhet dhe kryetari. Duket se gara nuk do të jetë e lehtë, pavarësisht se dhe dje për në Korçë kanë shkruar të gjithë bashkë, në atë start të fillimit të fushatës për zgjedhjen e kreut të ri të FRESH. Edhe pse Elisa Spiropali është tashmë e afirmuar si koordinatore kombëtare e FRESH-it prej tre vjetësh,

Artur Micko
"Unë s'jam në garë me kolegët e mi! E as ata me mua! Ne jemi në një garë shumë më të madhe, në garën për zemrën. Ndihem shumë i emocionuar që ndodhem në qytetin e Korçës, përballë të rinjve korçarë të cilët karakterizohen nga zgjuarsia, mikpritja".

Erlis Hoxha
"Unë jam këtu sot para jush, për të kërkuar mbështetjen tuaj, duke që në krye të FRESH, së bashku do të ngremë zërin fuqimisht për këto zgjidhje. Është e vërtetë që ne s'mund të hapim vende pune, por ne do t'i krijojmë të gjitha mundësitë të rinjve të informohen".

Joleza Koka
"Vota juaj për mua shënon jo fundin e një garë, por fillimin e saj. Garës për të shndërruar këtë forum në një shtëpi të fortë dhe të qëndrueshme, komode dhe tërheqëse. Gara për të mundësuar fitoren e PS-së në zgjedhjet e ardhshme. Me Jolezen FRESH bëhet shtëpia jonë e madhe miq".

Juxhin Çela
"Unë nuk dua të drejtoj FRESH-in për të bërë gara, për t'u bërë i njohur. Unë kërkoj ta drejtoj FRESH, me qëllim e vetëm që të përballim me këtë realitet dhe ta ndryshoj, këtë realitet që po na e bën të pamundur një jetesë normale. S'mund të pranoj që asnjë forcë të më përkulë".

Maria Myrindinas
"Unë jam Maria Myrindinas dhe kandidoj për të qënë kryetare e FRESH. Nëse të tjerët kërkojnë rezultate të mëdha, unë kërkoj zgjidhje të mëdha në shërbim të qytetarëve. Kandidoj për të qënë kryetare e FRESH. Do të më pëlqente jashtëzakonisht shumë ta merija përsipër këtë detyrë".

duket se dhe kandidatët e tjerë gëzojnë mbështetje në PS, kryesisht nga deputetë dhe anëtarë kryesia. Ku ndonëse nuk janë bërë publike, vetë publiciteti që pritet të jepet dhe në stacionin e PS tregon se ka dhe preferenca parcale që gjithsesi të lokalizuar dhe jo me ndonjë mbështetje të madhe sa të ndikojë në këtë fushatë. Që gjithsesi nga vetë entuziasmi i këtyre të rinjve tregon se ata përtej mbështetjes po tentojnë të kërkojnë mbështetje reale nga baza e të rinjve. Një model i tillë është i ngjashëm

me atë amerikan ku të rinjtë në ballafaqimet në të 36 rrethet e vendit me konferencat e FRESH në bazë do të marrin mbështetje, e cila do të përkthehet më 12 qershor në kongresin e këtij forumi me votë për të zgjedhur dhe kryetarin e ri, i cili do të drejtojë sipas statutit FRESH për katër vite. Dje kanë qënë në qytetin e Korçës dhe ku në orën 17.00 në një ambient vërtetë të ndezur kanë shpallur platformat respektive. Spiropali ka këmbëngulur dhe njëherë që FRESH duhet të marrë përsipër atë që i

takon, rivalizimin e të rinjve dhe kontributin në fitoren e PS dhe aleatëve për një Rilindje Shqiptare dhe për të vënë në jetë projektet rinore në një qeverisje socialiste. Ndërsa Artur Micko është shprehur se ndihet shumë i emocionuar që ndodhet në qytetin e Korçës, përballë të rinjve korçarë të cilët karakterizohen nga zgjuarsia, mikpritja dhe përpëhtësia. Për t'u pasuar nga Erlis Hoxha i cili ka kërkuar mbështetje, pasi duke qënë në krye të FRESH, së bashku do të ngrenë zërin fuqimisht për

zgjidhje. Joleza Koka ka deklaruar se vota për të shënon jo fundin e një garë, por fillimin e saj, garës për të shndërruar këtë forum në një shtëpi të fortë dhe të qëndrueshme, komode dhe tërheqëse. Gara për të mundësuar fitoren e PS-së në zgjedhjet e ardhshme. Në të njëjtën linjë dhe Juxhin Çela që kërkon drejtimin e FRESH për t'u përballur me këtë realitet e ta ndryshojë, këtë realitet që po e bën të pamundur sipas tij, një jetesë normale. Ndërsa Maria Myrindinas kandidon për të qënë

kryetare e FRESH për të dhënë zgjidhje të mëdha në shërbim të qytetarëve. Të gjashtë kandidatët, kush më shumë dhe kush më pak kanë tentuar të japin në mënyrën më të thjeshtë të mundshme atë që ndiejnë se mund të realizojnë, duke qënë në krye të FRESH, duke kërkuar në këtë mënyrë votën nga të rinjtë, në një mënyrë si asnjëherë tjetër, sipas modelit amerikan. Dhe ky është vetëm fillimi, që me sa duket do përfshijë dhe PS në një kohë më të vonshme, në kushte më të favorshme.



Topalli-studentëve që studiojnë jashtë: Kthehuni!

Kryetarja Jozefina Topalli nën prezencën e ish-praktikantëve të Parlamentit Gjerman nga Evropa Juglindore, dhe me temë: "Brain drain, brain gain; problematika në Shqipëri dhe Rajon", ajo vuri theksin tek e ardhmja që vendi ofron për të gjithë ata të rinj që mbarojnë studimet jashtë vendit, si një mundësi për të dhënë dhe ata kontributin e tyre në progresin drejt integritimit

europian. "Këto vite, falë reformave të ndërmarra, janë karakterizuar nga rikthimi në rritje të një numri të madh personash të kualifikuar jashtë vendit. Shpeshherë kam patur fatin të takohem me studentë që kanë studiuar jashtë vendit. Shumë prej tyre shtrinin gjithmonë një pyetje shumë të rëndësishme: "A ja vlen të kthehesh në Shqipëri?" përgjigja ime ka qënë përherë

një PO që vjen spontanisht dhe shumë e sinqertë.) Po, ja vlen të kthehesh në Shqipëri sepse sot Shqipëria është një vend i lirë dhe demokratik! Po, ja vlen të kthehesh në Shqipëri sepse Shqipëria është vetëm një hap prej integritimit të saj në Bashkimin Europian dhe kur kjo të ndodhë të gjithë ju do të ndiheni krenarë e do të thoni: edhe unë dhashë kontributin tim!" u shpreh Kryetarja e Kuvendit.

Diplomati i BE do të dalë në protestën e datës 17 Maj

Ambasadori holandez: Spahia, një injorant

"Presidenti? Duhet të zgjidhet me maksimumin e votave"

■ ■ ■ TIRANE

ILVA TARE

Ambasadori i Hollandës Henk G.C. Van Den Dool në Ora News, ka deklaruar se do të jetë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" për të mbështetur protestën e homoseksualëve, ndërsa i ka konsideruar "injorantë" të gjithë ata që fyejnë e shajnë këtë komunitet, duke iu referuar zotit Ekrem Spahia. Në lidhje me Presidentin, ambasadori Holandez vë në dukje se ai duhet të zgjidhet me konsensusin e të gjitha palëve.

Në 17 Maj, ditën ndërkombe-tare kundër homofobisë, ju do të merrni pjesë në një manifestim në Tiranë. Çfarë do të ndodhë ekzaktesisht atë ditë?

- Besoj që ju e dini që ambasada dhe unë personalisht kam qënë shumë aktiv në promovimin e të drejtave të njeriut, sigurisht edhe të drejtat e minoriteteve seksuale. Unë kam qënë në Shqipëri për katër vjet dhe kam qënë aktiv në një sërë mënyrash, në këtë fushë. Ajo që unë e gjej shumë interesante është se ajo ç'ka do të ndodhë javën tjetër, do të jenë një sërë eventesh, të organizuara nga organizata shqiptare, jo nga ne, por organizata të cilat punojnë për të drejtat e njeriut. Unë jam i kënaqur që do të marrë pjesë në to dhe do të tregoj mbështetjen time. Këto janë aktivitete të organizuara nga shqiptarët dhe jam i sigurtë që tre, apo katër vite më parë, një gjë e tillë do të kishte qënë e pamundur. Dhe unë shoh se ka një rrugë për të bërë. Ka lëvizje. Ka homoseksualë shqiptarë, të cilët janë tani të gatshëm të thonë se "unë jam gay". Ajo që më duket shumë interesante, është se kur para disa javësh, ka pasur një deklaratë nga një zëvendësministër shqiptar në lidhje me homoseksualitetin, nuk ka pasur reagime vetëm nga komuniteti ndërkombe-tar, por edhe nga komisioneria për anti-diskriminimin zonja Baraku, Avokati i Popullit, Totozani, madje edhe nga Kryeministri. Pra ne nuk jemi atje ku duhet, por unë jam optimist.

Po deklaratën e zotit Spahia si e cilësoni? Mendoni se ka njerëz të tillë që mendojnë si ai?

- Me siguri që ju e keni parë reagimin publik të BE-së, pjesë e të cilës kam qënë edhe unë, nuk dua që të harxhoj shumë kohë me këtë por më lejo të them që injorantë ka gjithandej. Unë ndjej që njerëzit duhet të edukohen në lidhje me këtë. Është e rëndësishme që njerëzit të informohen, të edukohen. Dhe ajo që unë e gjej fare të papranueshme dhe prandaj besoj se ka qënë arsyeja që ne e iniciuam atë reagim është kur një gjë e tillë del nga goja e një zyrtari të kabinetit qeveritar, sigurisht të gjithë kanë të drejtën të kenë opinionin e tyre, por duke qënë në pozicionin e një anëtarë të kabinetit qeveritar, që aspiron për t'u bërë vend anëtarë BE, nuk mund të thuhesh gjëra të tilla.

A mendoni se mënyra apo procesi se si do zhvillohet zgjedhja e Presidentit të Re-

publikës do të ndikojë në dhënieën apo jo të statusit?

- Mendoj se po dhe nuk besoj se jam i pari që po e them këtë gjë. Besoj se një numër kolegësh të mi, madje edhe komisioni europian e ka bërë këtë gjë shumë të qartë, sepse ne jemi shumë të interesuar për mënyrën sesi procesi do të marrë formë dhe do të ecë. Procesi është ai që do të tregojë një lloj maturie të partive politike në Shqipëri, prandaj është dhe një kohë shumë interesante. Jam shumë i kënaqur që po shoh zotin Meta, që takohet me zotin Rama, PD që po flet me partitë e tjera, sepse ne do të ndjenim që Kushtetuta shqiptare preferon një president konsensual, një kandidat që do të merrte sa më shumë vota, që do të ishte e mundur dhe ne mendojmë se do të ishte tregues për një pjekuri demokratike të partive, për të

...nuk dua që të harxhoj shumë kohë me këtë por më lejo të them që injorantë ka gjithandej. Unë ndjej që njerëzit duhet të edukohen në lidhje me këtë...

arritur në një kandidat të tillë dikë që e ka mundësinë të përfaqësojë unitetin e Shqipërisë si një vend dhe gjithashtu mund të mbrojë kushtetutën Shqiptare.

Ambasadori Amerikan u shpreh se preferohet një President në raundin e parë, ç'ka do të thotë konsensual. Qeveria holandeze e ka një preferencë të tillë apo mund të arrihet edhe në mënyrën tjetër kushtetuese, 71 vota?

Unë do të preferoja një president në raundin e parë me 140 vota, sepse një president me një mazhorancë sa më të madhe të jetë e mundur, do të ishte mënyra e vetme për të përfaqësuar unitetin e këtij vendi dhe sipas kushtetutës presidenti, nuk është një institucion politik dhe prandaj do të ishte e mrekulueshme, nëse ky parlament do kishte mundësinë t'i kalonte ndryshimet politike dhe të gjenin një personazh i cili nuk do të ishte vetëm i pranueshëm, por të kishin një njeri që të rrinte mirë në karrigen e presidentit. Kushtetuta parashikon 4 raunde nëse 3 të para dështojnë është edhe variant i fundit me një zgjedhje me shumicë të thjeshtë votash. Por sigurisht unë nuk mund të komentoj për këtë gjë, por kjo mund të jetë një parashikim i zgjuar në Kushtetutë, në mënyrë që të përjashtohet një tmerr

pa fund, sepse vendi ka nevojë për një president, por mesa kujtoj unë e kushtetuta është e shkruar në gjurmë e një presidenti të zgjedhur me një numër sa më të madh votash. Unë nuk dua të hyj me emra konkret, por mendoj se në Shqipëri keni emra të tillë. Duhet të jetë dinjitoz, do të ishte shumë mirë që ai mos të kishte një profil shumë të lartë politik, mos të ishte i lidhur me rregjimin e të kaluarës, do të ishte vërtet shumë mirë nëqoftëse ai do të ishte përmbi çdo lloj dyshimi në lidhje me korrupsionin, integritetin e tij.

Për dy vite me rradhë Shqipërisë i është refuzuar statusi kandidat, për shkak të kriterit politik. Cilët janë kriteret me të cilët kemi më shumë probleme, ato teknike apo ato politike?

- Ne besojmë që flasim për procesin politik më shumë sesa për atë teknik dhe për të qënë i sinqertë, deri në fund për ta quajtur këtë një proces teknik, është një mënyrë kamufllazhi për të fshehur atë që është e vërtetë. Sapo Shqipëria aplikoi për statusin e vendit kandidat, ne pamë që ajo që ishte më e nevojshme ishte dialogu politik. Ka 12 kriterë kryesorë, të cilat janë caktuar që në vitin 2010, ato ndoshta janë vendosur në një gjelb teknike, por ato kanë të bëjnë në thuh me dialogun politik dhe këto 12 kriterë kryesorë, nuk janë shumë të vështira. Unë gjithmonë kam ndjesinë se vende si Maqedonia, Bosnja kanë



Ambasadori i Hollandës Van Den Dool

disa herë më shumë probleme më të vështira sesa Shqipëria dhe në Shqipëri është vetëm çështja e dialogut politik që çalon. Ajo që unë shoh tani është që nga

Nëntori i vitit të kaluar, ka një lloj dialogu dhe gjëra që për një farë mënyre po ecin. Sigurisht, kjo nuk do të thotë që janë arritur standartet dhe statusi i vendit kandidat do t'ju jepet në një pjatë të argjendtë, por ju duhet të vazhdoni me përpjekjet tuaja.

Ju keni bërë një deklarament vit më parë, ku keni thënë se politika në Shqipëri, nuk prodhon vlerat e demokracisë. Atëherë pse shqiptarët i votojnë këta politikanë?

Nuk jam i sigurt nëse e kam thënë në këtë kontekst, por unë e kam thënë që unë e gjej shumë të vështirë, për të bërë dallim midis partive politike për t'i dalluar nga njëra-tjetra. Nuk është e lehtë në Shqipëri që të bësh dallim midis partive politike mbi bazën e ideologjive dhe programeve të tyre, sepse nuk ka diskutime fare në lidhje me sistemin armisor, sistemin shëndetësor gjithçka është e udhëhequr rreth personaliteteve dhe rreth tyre vërtitet gjithçka. Në lidhje me pyetjen tuaj përse njerëzit votojnë këta politikanë? Besoj që kjo është një pyetje shumë interesante dhe besoj që tani që kam 4 vjet që jam në Shqipëri, njerëzit kanë një lloj memorje historike, ku asnjeheri liderët e tyre nuk janë kujdesur për ata, qofshin ata pushtuesit e huaj apo komunistët. Pra ata që janë elita udhëheqëse, nuk punojnë për njerëzit dhe besoj se shqiptarët, nuk janë mësur me idenë tjetër që në demokraci funksionon ndryshe, sepse në momentin që ti voton për ata, ata duhet të punojnë për ty, duhet të kthejnë mbarsht shërbimet që ti i ke besuar. Unë mendoj nga ana tjetër, që njerëzit në Shqipëri kanë filluar mos t'ja venë më veshin politikës, jo Tiranë, sepse Tiranë është një ishull i veçantë, por në përgjithësi kur flet me ta, ata nuk është se ia venë më shumë veshin politikës. Sigurisht ata mundohen të merren me hallat e tyre dhe njerëzit sigurisht shohin manifestime të mëdha, por kur ti del nga Tiranë dhe shkon nëpër vende të ndryshme në Shqipëri, njerëzit atje nuk ndihen shumë të përfaqësuar nga politikanët.

Z.Ambasadori në demokracinë e konsoliduara votuesit votojnë partitë politike në varësi të moralit që ato sjellin. A ka lidhje pushteti me moralin?

- Shpresoj që të ketë një lidhje midis politikës dhe moralit, por jo domosdoshmërisht në demokracinë e konsoliduara. Unë shpresoj që të jetë e njëjta gjë në Shqipëri dhe do lloj demokracie tjetër, secili ka të drejtën për të qënë politikan dhe për të kërkuar votat e njerëzve.

Deklarata

Presidenti Topi i hap rrugën hetimit të EULEX



Presidenti Bamir Topi ka dekretuar ditën e djeshme ligjin për Gjykatën Administrative, dhe atë për hetimin e EULEX për trafik organesh në Shqipëri. Në faqen zyrtare të presidencës janë publikuar dekretet, me firmën e kreut të shtetit, që i hap kështu rrugë zbatimit të këtyre dy ligjeve. Gjykata Administrative u miratua me konsensus në seancën e kaluar, ndërsa ajo e EULEX mori votat seancën e së enjtes në sallën e Kuvendit të Shqipërisë. "Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, si dhe nenit 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, Dekretet: Shpalljen dhe dhënieën e përligimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 53/2012 "Për marrëdhëniet juridikionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it". Ky dekret hyn në fuqi menjëherë".



"Terroristi" mbetet në burg, e padit dhe bashkëshortja

Gjykata e Tiranës ka caktuar masën e arrestit në burg për shtetasin e arrestuar Denis Shmilli të cilit gjatë një kontrolli në banesë ju sekuestruan dy bomba me telekomandë. Arrestimi i të riut nuk u njoftua në Komunikatën Zyrtare të Policisë, ndërkohë që edhe masa e sigurisë ndaj tij edhe pse ishte caktuar për t'u kryer në orën 10:00 të kësaj të premtjeje u

bë një orë para kalendrit, duke shmangur madje edhe praninë e avokatit mbrojtës. Seanca për caktimin e masës së sigurisë është zhvilluar pa praninë e avokatit të tij mbrojtës Alban Bengasi, ndërsa në vend të tij gjykata ka caktuar një avokat kryesisht. Ndërkohë që dje në gjykatën e Tiranës është rregjistruar një padi civile nga bashkëshortja e Denis Shmillit, shtetësja

Rudina Mata. Kjo e fundit i është drejtuar gjykatës së Tiranës, duke kërkuar urdhër mbrojtës për shkak se sipas saj bashkëshorti e keqtrajton. Në fakt ka qënë një denoncim i bërë në policinë e Tiranës nga vetë bashkëshortja e tij, ku pas një kontrolli në banesë efektivat e policisë kanë arritur të gjejnë dy bomba me telekomandë.

Gjykata e Tiranës e shpall të pafajshëm pas 6 muajsh

Shullazi fiton lirinë nga zyra e gjyqtarit

Dënon me 1 vit burg Danin, për pistoletën "Glock"

Lajmi

Nga ambjentet e zyrës dhe jo në sallë, gjyqtari Martin Deda ka liruar Emiljano Shullazin nga akuzat e armëmbajtjes pa leje dhe dënuar shokun e tij Gilmando Dani me 1 vit burg. Në pasditen e djeshme, Shullazi ka lënë qelmin e burgut 302, ndërsa prokuroria tha se shumë shpejt do e apelojë vendimin.

TIRANE

ELTON QYNO

Emiljano Shullazi, ka mundur tia hedhë më së miri drejtësisë edhe një herë tjetër, duke arritur të manipulojë dëshmitë e policave e të lirohet nga ambjentet e burgut 302 në Tiranë. Ndërkohë që për sa i përket të pandehurit tjetër, shokut të Shullazit, Gilmando Dani, ky i fundit ska mundur të kalojë derën e burgut për shkak se gjykata e ka dënuar me 1 vit burg, jo për akuzën e ngritur nga prokuroria për "Mos kallëzimit të krimi" por për "Armë mbajtjes pa leje". Nga ambjentet e zyrës së tij, gjyqtari i çështjes Martin Deda ka dhënë vendimin duke nxjerrë të pafajshëm Emiljano Shullazin dhe dënuar shokun e tij Gilmando Dani. Mësohet se në vendim gjyqtari i është referuar dëshmitë të dhëna në gjykatë të policave si dhe vëllait të pandehurit Gilmando Dani, i cili në njërin nga seancat, ka pohuar se i kishte parë të vëllait një pistoletë, tekta ai dilte nga ambjentet e shtëpisë. Në dëshminë e tij, vëllai i Gilmando Danit sqaron se "I kam thënë vëllait pse e mban me vete këtë armë, ndërsa ai më është përgjigjur se e mbante për shkak se i ka shpëtuar një atentati mafioz dhe se ishte i kërcënuar për jetën. Pas kësaj bisede Gilmando është larguar nga banesa së bashku me armën që kishte me vete". Duke ju referuar kësaj dëshmie, por edhe thëniet e ndryshuara nga dy efektivë policie me inçilatat F. S. dhe E.M. të cilët kanë bërë arrestimin e dy të pandehurve, gjykata vendosi të pushojë akuzën për Shullazin dhe të shpallë të pafajshëm atë, ndërsa për Danin vendosi të zëvendësojë akuzën nga "Mos kallëzim krimi" në "Armë mbajtje pa leje".

DY POLICËT NË HETIM

Punonjësit e policisë F.S. dhe E. M., të cilët në dëshmitë të tyre përpara gjykatës kanë dëshmuar për rrethana të



Emiljano Shullazi

ndryshme nga ato që kanë deklaruar përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe përpara prokurorit, rrethana të ndryshme nga ato të pasqyruara në aktin e procesverbalit të kësaj në flagrancë, kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Dëshmisë së Rreme" parashikuar nga neni 306 i K. Penal dhe do të merren në përgjegjësi penale. Në dëshminë e tyre përpara gjykatës ata kanë deklaruar rrethana të ndryshme për ngjarjen nga sa kanë dhënë

në deklaratim e tyre përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe përpara prokurorit, ku ata shpjegonin me hollësi se armën pistoletë të tipit "GLOCK" e ka nxjerrë nga brezi shtetasi Emiljano Shullazi, i cili në atë moment e ka hedhur sipër kofanos se një makinë. Nga ana e prokurorisë këto dëshmi janë kundërshtuar duke kërkuar leximin e deklaratimeve të tyre të bëra përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe prokurorit, deklarime këto

DËSHMIA E POLICËVE

"Shullazi e hodhi armën Dani u përpoq ta fshehtë"

Menjëherë kemi identifikuar njërin prej tyre, mi i cili ishte Emiljano Shullazi, kemi qëndruar afër automjetit të tyre dhe sa kemi zbritur nga makina, njëri prej tyre është larguar me vrap duke mbajtur në dorën e djathtë një armë zjari pistoletë. Personi që u largua e kemi ndjekur për 200 deri në 300 metra, por pa mundur ta ndalojmë. Ndërkohë që në këtë moment Emiljano Shullazi ka nxjerrë nga brezi një pistoletë dhe e ka hedhur mbi një makinë tjetër, por arma nuk është rëzuar poshtë. Gilmando Dani është përpjekur ta rëzojë nga makina armën e krimi, por s'ka mundur dot".

që lidhen me prova të tjera të papërsëritshme (pr.kapjes në flagrancë) që gjenden në fashikullin gjyqësor dhe që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Kundërshtime, të cilat nuk janë pranuar nga ana e gjykatës.

APELIMI I VENDIMIT

Prokuroria e Tiranës shprehet se pas marrjes së vendimit të zbardhur do i drejtohet gjykatës së apelit, ku do i kërkojë kësaj të fundit prishjen e vendimit dhe lënien në fuqi të masave të dënimit të


kërkuar prej saj. Në pretendencën e organit të akuzës, u kërkuar dënimi me 4 vjet heqje lirie të të pandehurit Emiljano Shullazi dhe me 1.6 vite burg për shokun e tij Gilmando Dani. Ky i fundit që në momentin e arrestimit ka pretenduar se arma tip "Glock" ka qënë e tija dhe jo e Shullazit. Mirëpo këto dëshmi janë rëzuar gjatë fazës hetimore, nga deklaratimet e policëve që më pas bënë dhe ndryshimin e dhënies në seancën gjyqësore.

Dyshime për vrasje

Tiranë, gjendet i varur ish-oficeri

TIRANE

Një ish-oficer ushtrie është vetë varur në kodrat e liqenit artificial në Tiranë. Viktima është 65 vjeçari Halim Vata i cili është gjendur mesditën e djeshme i varur në një pemë. Nga burime pranë policisë mësohet se Vata ishte larguar nga banesa tre ditë më parë, ku dhe kishte lënë një letër për familjarët ku tregonte se do të vetëvritej, për shkak se nuk mund ta shtynte dot jetesën në këtë gjendje. Pavarësisht këtij fakti, policia e Tiranës është duke e hetuar ngjarjen për një vrasje të mundshme për shkak se dhe mekanizmi si kishte ndodhur ngjarja linte për të dyshuar. Familjarët e viktimës, pretendojnë se 65 vjeçari nuk



vuante nga asnjë sëmundje mendore dhe se kishte arsye për tu vetëvrrarë. Ka qënë pikërisht gjetja e letrës, ajo që ka alarmuar familjarët dhe policinë, duke

kryer kontrolle në disa zona të Tiranës, por pa mundur ta gjejnë 65-vjeçarin. Dje paradite, ai është gjetur te Kodrat e Liqenit nga dy vajza, që kanë njoftuar policinë. Në vendin e ngjarjes kanë shkuar menjëherë shërbimet e Komisarariatit nr. 1, që e kanë gjetur 65-vjeçarin të varur me një tel, të cilin e kishte lidhur në pemë. Menjëherë janë thirrur ekspertët, të cilët kanë bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes, ndërkohë që gjatë këqyrjes së kufomës, është vënë re një shenjë pas koke, që mund të jetë edhe goditje nga mjete të forta. Por kjo, për grupin hetimor nuk është provë e mjaftueshme për të vërtetuar shkakun e vdekjes, kështu që do të mbledhë komisioni, me qëllim për të dhënë konkluzionet nëse kemi të bëjmë me vrasje apo vetëvrasje.

LAJME SHKURT

Mbytet 45-vjeçari sheri bëhet në këshill të qarkut

Tre jave pas mbytes së banorit në Kaçinar të Mirditës Llesh Karrica, kreu i komunës ka shpërthyer në akuzat të ashpura gjatë mbledhjes së këshillit të qarkut. Ai ka akuzuar si policinë për mos ndërhjyrjen në kohë, ashtu edhe qarkun se nuk mori masa për rihapjen e rrugës pas shkarjes së dherave, që izoluan tetë fshatra. 45-vjeçari Karrica pas bllokimit të rrugës tentoi të kalonte në lum, por rrjedha e mori atë me vete. Edhe tre jave pas mbytes trupit i viktimës nuk është gjetur ende.

Shisnin kokainë në restorat, pranga shqiptarit

Në lokalin e tij shërbente në tavolina specialitete peshku, por klientëve më të përzemërt u shërbente edhe drogë. Me këtë akuzë përfundoi në burg pronari i një restoranti në Rosa të Vigezës në Itali. Bëhet fjalë për 50 vjeçarin Luigi Pierobon, i cili u prangos pas 4 muajsh hetimesh, ku gjatë kësaj kohe u studuan klientët dhe blerësit e drogës në restorat. Bashkë me italianin përfundoi në burg shqiptari Admir Muho me banim në Verona. Sipas policisë thuhet se 33 vjeçari shqiptar u kap me një sasi kokaine para restorantit të cilën po ia dorëzonte pronarit, ndërsa në xhep kishte 1250 euro. Lënda narkotike e cilësisë më të mirë ishte pakëtuar dhe fshehur brenda një kutie me patate të cilën shqiptari po e sillte në restorat, në rolin e furnizuesit të lokalit.

Kapshiticë kthehen mbarsht 50 shtetas

Autoritetet greke në Kapshiticë vijojnë të kthejnë qytetarët shqiptarë që udhëtojnë me pasaporta biometrike në shtetin grek. Së paku 50 qytetarë shqiptarë nga rrethe të ndryshme të vendit janë kthyer në kufi edhe pse kanë plotësuar kushtet e Shengenit, duke patur me vete lejen e qëndrimit, apo edhe sasinë e duhur të parave. Ndërkohë që nuk janë sqaruar nga doganierët grekë për kthimin pas. "Sa u futa në doganë, me garanci me letra me vula në rregull më kthyen. As vetë nuk e kuptova, lekët i kisha. Kthyen gjithë autobusin, jo vetëm mua" shprehet një qytetar.



Klandestinë Sirianë drejt Gjermanisë kapen në Tiranë

Tre klandestinë Sirianë janë arrestuar dhe nga policia e Tiranës, pasi ishin fshetur brenda një kamioni që kishte mbëritur në Shqipëri nga Turqia. Konstatimi i tyre është bërë gjatë një kontrolli fizik të një maune turke me targë 27 R7020/35H4195 drejtuar nga shtetasi turk Yildirim Cemal, e ngarkuar me tapetë. Gjatë kontrollit u zbuluan të

fshetur shtetasit sirianë, Josuf Mehmet 24 vjeç, Shefik Hali 46 vjeç dhe Bale Hali 19 vjeç. Menjëherë u njoftuar strukturat e hetimit, të antikontabandës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe forcat e Policisë së Shtetit. Nga deponimet e para të tre klandestinëve rezultoi se ata ishin futur në maune në Turqi me piksynim mbëritjen

klandestinë në Gjermani. Teknika e përdorur për futjen e klandestinëve sirianë në maune, siç rezultoi nga kontrolli fizik i mjetit, është prishja e elementëve të sigurisë këputja e kavos dhe ribashkimit të saj. Klandestinët iu dorëzuan autoriteteve policore ndërsa për drejtuesin e mjetit, shtetasin turk Yildirim Cemal, u mor masa e ndalimit.

Padia në gjykatë për braktisjen e emisionit Zig-Zag

TVSH: Gjobë 25 mln lekë Mevlan Shanajt

Regjizori u rebelua pas censurimit të dialogjeve

Lajmi

Televizioni Publik Shqiptar i kërkon 25 milion lekë të vjetra regjizorit Mevlan Shanaj, pasi pretendohet se ky i fundit i ka shkaktur dëmtimin e imazhit. Padia është depozituar në gjykatën e Tiranës dhe pritet që shumë shpejt gjyqtarja Elbana Lluri të hapë procesin gjyqësor.

TIRANE

ELTON QYNO



Aktori Mevlan Shanaj

Regjizori i njohur Mevlan Shanaj është paditur në Gjykatën e Tiranës, nga drejtuesit e Radio Televizionit Shqiptar. TVSH-ja i kërkon regjizorit dhe aktorit Shanaj dëmshpërblimin me një shumë prej 25 milion lekë të vjetra, për shkak se sipas objektit të padisë ai i ka shkaktuar një dëm moral imazhit të këtij televizioni. Padia kundër Mevlan Shanaj është depozituar në sekretarinë e gjykatës së kryeqytetit nga juristi i televizionit publik, ndërsa është regjistruar në datën 5 maj të këtij viti. Çështja civile mban numrin 12008 dhe ka si objekt të saj dëmshpërblimin në vlerën prej 2 500 000 lekë, si dëm moral të shkaktuar nga i padituri gjatë shfaqjes "live" të programit "Zig Zag" të transmetuar në 20 prill në ekranin e televizionit shqiptar. Sipas akt padisë, pikërisht në këtë datë regjizori Mevlan Shanaj ka qënë i ftuar në emisionin "Zig Zag" për të promovuar dhe folur rreth filmit "Pharmakon", ku ai është producent ndërsa djali i tij Joni Shanaj është regjizori. Teksa ishte duke u transmetuar emisioni, prezantuesja e tij Migena Kraja i ka kërkuar regjisë të transmetojë një pjesë nga filmi "Pharmakon", dhe më pas diskutimi të vijonte në studio rreth realizimit të filmimit.

SKENAT EROTIKE
Pjesa që kishte zgjedhur për të transmetuar televizionit shqiptar ishte disa minuta, ku mes të cilave ishte futur dhe disa skena erotike si dhe diskutime me përmbajtje të kësaj natyre. Këto fjalë ishin bërë me zhurmues nga ana e montazhierëve dhe nuk u transmetuan ashtu siç ishin regjistruar gjatë filmimeve. Pas përfundimit të insertit, linja është kthyer në studio ku

mësohet se në këtë moment regjizori Mevlan Shanaj ka marë fjalë duke pretenduar për një censurim të filmimit nga ana e drejtuesve të Radio Televizionit Shqiptar. Disa prej fjalëve që u ishte vendosur sinjali zhurmues, burime pranë TVSH-së thanë se regjizori Shanaj i ka thënë në studion e emisionit "Zig-Zag", duke bërë një veprim ofendues dhe që prish imazhin e ekranit të televizionit. Po këto burime thanë për gazetën

"Shqiptarja.com" se regjizori Shanaj ka fyer hapur e me fjalë të rënda, ndërsa e ka lënë në mes emisionin duke i vënë në vështirësi përgjegjësit e këtij emisioni dhe sidomos moderatorin Migena Kraja. "Duke e konsideruar këtë një dëm të rëndë ndaj televizionit Publik Shqiptar, zyra juridike ka bërë padin ndaj Mevlan Shanajt"-shtuan burimet pranë këtij televizioni. Nisur nga kjo situatë televizioni i kërkon gjykatës që të detyrojë

r. i Çështjes:	12008
Dt. e regjistrimit:	08.05.2012
Paditesit:	Radiotelevizioni Shqiptar
Te paditurit:	Mevlan Shanaj
Lloji i Çështjes:	Padi Shkaktim Demi (Neni 608-654)
Baza Ligjore:	Neni 608 - 654
Objekti:	Dëmshpërblimi në vlerën 2 500 000 leke si dëm moral të shkaktuar nga i padituri gjatë shfaqjes live të programit ZIG ZAG me date 20 04 2012 në Televizionin shqiptar
Statusi i dosjes:	Gjykim
Gjyqtari:	Elbana Lluri
Padia e regjistruar në gjykatë	

regjizorin Shanaj për të dëmshpërblyer me 25 milion lekë të vjetra TVSH-në për shkak të prishjes së imazhit.

PRETEDI MI I RREGJIZORIT

I kontaktuar nga gazeta regjizori Mevlan Shanaj në një lidhje telefonike ka pohuar fillimisht se nuk kishte dijeni për padinë e bërë nga drejtuesit e televizionit Shqiptar. Ndërkohë që më pas ai ka treguar se ky veprim mund të jetë një lajthitje e adminis-

tratis së këtij televizioni, pasi nuk mund të padisë njeri regjizorin Shanaj. Ky i fundit ka shtuar se shumë shpejt do mbyllët kjo çështje dhe se asnjë gjë nuk ka për të ndodhur, për shkak se do bisedojë rreth kësaj çështje me drejtuesit e televizionit publik shqiptar. Mevlan Shanaj është një nga regjizorët dhe aktorët më të njohur në kinematografinë shqiptare, ku gjatë karrierës së tij ka luajtur qindra role të njohur në film por dhe në teatër.

LAJME SHKURT

Grabiti me armë, ekstradohet 27-vjeçari

Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana ka bërë dje ekstradimin e një personi të shpallur në kërkim për vrasje, të kryer tetë vite më parë. Personi i ekstraduar është, Nertil Hekuran Hoxha, 27 vjeç lindur në Berat. Hoxha kërkohet nga drejtësia shqiptare, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.76, datë 27.03.2006, e ka dënua atë me 12 vjet burg, për kryerjen e veprave penale të "Vjedhjes me armë, të kryer në bashkëpunim". Hoxha, më 19 gusht 2004, në afërsi të fshatit Strum, Roskovec, në bashkëpunim me dy shtetas të tjerë ka kryer vjedhjen me armë të një mjeti tip Mercedes Benz në pronësi të shtetasit A.C.

Kali, shisnin Italianë kapet çifti shqiptar

Një çift shqiptarësh Alfred Tanushi 26 vjeç dhe Xhulliana Ymeri 20 vjeç u arrestuan nga policia e Savonas në Itali të akuzuar për tregti dhe për shpërndarje të lëndëve narkotike. Dy të rinjve policia u gjeti me vete rreth 200 gramë kokainë e ndarë në doza e përgatitur për tu shitur. Policia ishte vënë prej kohësh në ndjekje të dy të rinjve të cilët frekuentonin të njëjtat vende, takoheshin me të njëjtë njerëz dhe kishin lëvizje të dyshimta. Në kohën e pranngosjes çifti i shqiptarëve sapo i dorëzuan dy doza kokaine një të riu, gjë që bëri arrestimin e tyre në flagrancë.

Filmi "Pharmakon"

Fabula, histori dashurie mes dy të rinjve

TIRANE

Ndonëse "Pharmakon" është një film tërësisht shqiptar, ai ka përmbledhur mesazhe nga vende të ndryshme të botës. Joni Shanaj, skenaristi dhe regjizori i këtij filmi ka guxuar të shfaqet me debutimin e tij të parë në një film me metrazh të plotë. Ai ka ftuar në role disa nga emrat më të njohur në botën e artit. Klevis Bega, i njohur si Kastro Zizo, ka portretizuar personazhin kryesor të filmit, Brankon. Ai interpreton marrëdhënien e Brankos me babanë e tij Dr. "Pharmakon", ku kërkon të na tregojë sesi egoja e babait, dëshira dhe uria e tij për pushtet në thelb go-



dasin të birin. Partnerja e tij Sonja portretizohet nga Olta Gixhari. Shanaj pohon se "Olta Gixhari vjen në këtë film në një rol të plotë dhe të vështirë", duke shtuar se për realizimin e këtij filmi ka pasur mjaft bashkëpunime me artistë dhe vende të ndryshme të botës. Janë dy drejtorë fotografie, Ji-Hvvan Park nga Seul, Koreja e Jugut, dhe Ram Shani nga Tel Aviv, Israel. Ndër të tjera ai thotë se "muzika e filmit është kompozuar nga Anton Lennartsson, një kompozitor i ri dhe i talentuar suedez". Deri në finalen e filmit u bë një rrugë e gjatë. Fabula e filmit përqendrohet në marrëdhënien e një djali dhe një vajze, Brankos (Kastro Ziso) dhe

Sarës (Olta Gixhari) një studente mjekësie dhe infermiere në spitalin e Tiranës. Dashuria e të rinjve është një dashuri e pjesshme e mbushur me xhelozie dhe dyshim. Shmërtimisht, filmi flet për një gjeneratë të re e cila e ka të pamundur të dalë nga shtypja dhe tutela e një shoqërie të shkatërruar. "Dua të theksoj se Pharmakon, është një film për brezin tim. Ngjarjet zhvillohen në Tiranë dhe ky është një film për ne", thotë Joni Shanaj, biri i dy artistëve të njohur Natasha e Mevlan Shanaj. "Pharmakon" kërkon të ngrejë disa pikëpyetje në lidhje me situatën veçanërisht të shtresave të mesme dhe të larta dhe te ardhmen e tyre.

Së shpejti...

televizioni më i ri informativ në Shqipëri

A1 REPORT!

Redaksia & Marketing

Rruga: "Dervish Hima",
Tërë kullat, kulla e dytë, Tiranë
mobile: +355 69 60 60 421
marketing: +355 69 60 60 419

Studiot e prodhimit A1
Rruga: "Aleksandër Moisiu"
ish-Kinostudio Shqipëria Sot

origjina e lajmit...

Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat profesionale të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike



Lajmi në High Definition

Mund ta ndiqni A1-Report në këto televizione kablore:

NE SHQIPERI

Televizioni Qyteti
MRM Korçë
Intel Media Fier
Inkusat Pogradec
TVM Devolli Devoli
Vjosa Vlore
Toshkez Lushnje
Bradstat Elbasan
Erzeni Shijak
Luna Kavaje
Maruxho Sullize
Permeti Permet
Iria Berat
Policani Berat
Ebas North & South Elbasan
Kombi Fier

Lushnja Lushnje
Prenjas Prenjas
Alfa Kabelel Tirane
Cakran Fier
Kucova Kucove
Lapardhaja Berat
Brado Elbasan
Orkumi Vlore
Asparag Rrogozhine
Mati Mat
Kukesi Kukes
Orexi Fier
Magellara Diber
Multivizion Kavaje
Tata Junior B.Curri
Dijaka Lushnje
M&G Elbasan
Ura Vajurore Berat
Saranda Digital Sarande

Pupa Lushnje
Roskovec Fier
HB-CA Peshkopi
Eri A&A Ballsh
Irina Berat
Raci KGM Lezhe
S3 Tirane
Ju-al Kruje
Mamurras Lac
Manastiri Fier
Belshi Elbasan
ARD&NET Fier

NE MAqedoni

Multimedia Maqedoni
Telenet Maqedoni
Skupi Cable Maqedoni

VALË UHF
NË PREFEKTURAT:
TIRANE-DURRES-LEZHE-FIER

ABC
KANALI 158

DIGITALB

KANALI 50
Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë,
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi
dhe në pjesën tjetër të Europës



CILJETA XHILAGA
KËNGETARJA NDAHET NGA
ALEKSANDRI, NUK E PRANON

BIG BROTHER 5
GENTA DHE FRANCESKA
PUTHEN NE BUZE



WWW.SHQIPTARJA.COM

Suplementi i së shtunës te SHQIPTARJA.com

THASH & THEM

NR. 14 E shtunë, 12-05

E-mail: thashethem@shqiptarja.com



EKSKLUZIVE
FLET
KËNGETARJA

ELVANA GJATA

"GJAKU IM" VIDEO
KU PERGJAKEM

RRËFIMI PËR PRAPASKENAT E KLIPIT




GRACIANO TAGANI

Me Lorin tashmë
shijojmë dhe ditën



STELA DHE KLEJVIS
"Nudoja jonë" së
shpejti në radio



KLAJDI HARUNI
Pas "Mamicës"
femrat më gjuajnë

RILIND
REKA

Harron Tunën martohet
për të dytën herë



Dancing

ELEMINOHET SELDI
JA PRAPASKENAT E
KONKURRENTEVE



ELVANA GJATA:

“Gjaku im”, një video ku përgjakem

“Sa më e fortë gara në DWS, aq më e fortë edhe unë”

SUADA DACI

Cdo projekt apo angazhim i saj në art, përkthehet gjithnjë me sukses. Bëhet fjalë për këngëtares e mirënjohur, Elvanë Gjata, e cila kohët e fundit ka nxjerr në treg këngën e saj “Gjaku im”. Si çdo këngë edhe ky projekt i ri i saj, është pëlqyer shumë nga publiku duke marrë mbi 280 mijë klikime në YouTube. Në një intervistë ekskluzive për suplementin THASH&THEM, Elvana Gjata rrëfen projektet e saj dhe prapaskanat e videos, “Gjaku im”. Duke e cilësuar atë si nga projektet e saj më të mira, Elvana shprehet se, kjo këngë trajton një temë që ka e shqetësuar vërtet mendjen dhe zemrën e saj. Këngëtarja thotë se, këtë këngë e ka interpretuar me aq ndjenjë, saqë nga duart e saj të lidhur me zinxhirë, ka dalë vërtet gjak. Por nuk është vetëm muzika ajo që zë një vend të rëndësishëm për Elvanën. Prej 7 javësh publiku shqiptar, po e shikon këngëtares të mbërthyer nga ethet e garës të “Dancing With the Stars”. E shoqëruar në këtë kompeticion nga balerini Gerd Vaso, Elvana edhe në këtë angazhim të ri të saj, duket se po ecën mjaft mirë duke u renditur, ndër konkurrentet e para më të votuara dhe të pëlqyera nga publiku shqiptar. Ndonëse gara në DWS po bëhet më e fortë, edhe Elvana Gjata, po përgatitet më shumë për të arritur suksesin në këtë kompeticion. Por sfidat për artisten nuk përfundojnë këtu. Pjesë e axhendës së saj artistike, do të jetë edhe një tjetër konkurs i rëndësishëm, siç është “Balkan Music Award”, ku Elvana konkurren me klipin e saj “Afër dhe Larg”, përkrahë emrave të njohur të muzikës ballkanike.

Ka pak javë që është lanuar, kënga juaj “Gjaku im”, dhe duket se ka marrë më shumë se 280 mijë klikime, si ndiheni?
 Ndihehem shumë mirë që interesimi i publikut sa vjen dhe rritet ndaj projekteve

të mia më të reja. Kjo mbështetje e publikut më motivon shumë për punë edhe më të mira.

Në këtë këngë vini ndryshe, në rrymën në pop rock, pse kjo zgjedhje?
 Gjithmonë kam dashur të vij ndryshe. Larmishmëria për një artist është më se e nevojshme, për të pasuruar figurën e tij. Duke qenë një këngë me mesazh të fortë një rrymë e tillë i përputhet më së miri. Por në repertorin tim nuk është e vetmja këngë në këtë rrymë, pasi edhe këtu e gjej veten shumë mirë.

Edhe kjo këngë mban vulën e kompozitorit Flori Mumajesi, pse ja besoni gjithnjë Florit këngët tuaja?



Do thoja që është një marrëdhënie reciproke.

Do të kemi një tjetër projekt muzikor nga ju, meqenese vjen edhe sezoni veror? Keni ndonjë projekt gati?
 Po jam duke punuar për një singël të ri.

Sa ju pengon “Dancing” për tu marrë muzikë?
 Asgjë nuk më pengon të merrem me muzikë (qesh), edhe pse më duhet të pranoj që pjesëmarrja në “Dancing with the Stars”, kërkon një impenjim dhe përkushtim maksimal. Megjithatë jam e aftë ta organizoj ditën në mënyrë, që të bëj atë çka duhet me energji të dukura, duke përfshirë muzikën dhe kërcimin.

Jemi në javën e shtatë të DWS, sa e përgatitur ndihet Elvana tani kur gara po bëhet akoma më e fortë?
 Sa më e fortë bëhet gara aq më e fortë bëhem edhe unë (qesh). Më shtohet dëshira për të punuar dhe kërcyer çdo ditë e më shumë. Po e shijoj shumë si eksperiencë. E ndjej që po plotësoj

Asgjë nuk më pengon të merrem me muzikë (qesh), edhe pse më duhet të pranoj që pjesëmarrja në “Dancing with the Stars”, kërkon një impenjim dhe përkushtim maksimal

dhe pasuron një pjesë të rëndësishme të figurës time artistike.

E shikoni veten në finalen e këtij spektakli?
 Të them të drejtën besoj shumë, tek aftësia ime për të kërcyer, por kjo gjë bëhet dhe më e fortë kur e ndjen, që ke një publik mbarë shqiptar që të mbështet.

Sa suport e keni Gerdin në këtë kompeticion?
 Gerd është partneri më perfekt që mund të më shoqëronte gjatë këtij kompeticioni. Profesionalizmi i tij më shtyn për të dhenë më të mirën time. Të kërcesh me një yll të baletit shqiptar, është jo vetëm kënaqësi por edhe përgjegjësi shumë e madhe për mua.

Mendoni që pjesëmarrja në Dancing do t’i ndihmojë, gjatë performancave në këngët tuaja?
 Po besoj që kërcimi do të zë një vend shumë të rëndësishëm në vazhdimësi.

Në cilën nga disiplinat, ndiheni më komode?
 Në kërcimet latine. Tango, Pasodoble, Rumba i ndjej shumë afër vetes. Janë disiplina që kërkojnë shumë interpretim, ndjenjë, personalitet, forcë.

Cili ju duket kërcimi më i vështirë?
 Deri tani më e sikletshme ka qenë Jive.

Elvanë 10 pikëshin tuaj të parë në DWS, e keni marrë nga ish-profesori juaj, Alfred Kaçinari, si u ndjetë?
 Shumë mirë. Uroj të më shoqëroj deri në fund (qesh). Më riktheu edhe një herë në kujtimet e “Etheve” dhe pse jam koshiente për vitet që kanë kaluar. U binda edhe një herë që koha është treguesi më i mirë.

Në fakt si i merrni vlerësimet e jurisë, jeni mërzhitur me komentet e tyre?
 Unë e vlerësoj gjykimin e jurisë, qoftë pozitiv apo negativ. Në rastin tim kanë shërbyer për mirë, pasi kam rregulluar defektet e mija. Pastaj unë jam pro silloganit të këtij kompeticioni, “Juria gjykon, publiku vendos”.

Tani që provuat eksperiencën e kërcimit, jeni pënduar që e latë baletin?
 Jo. Mendoj që çdo gjë ka ardhur në kohën dhe momentin e duhur.

Cilin shikoni si konkurrentin më të fortë të DWS?
 Gjithsecili prej konkurrenësve ka një karakteristike, që i bën konkurrent të fortë.

Unë e vlerësoj gjykimin e jurisë, qoftë pozitiv apo negativ. Në rastin tim kanë shërbyer për mirë, pasi kam rregulluar defektet e mija. Pastaj unë jam pro sloganit të këtij kompeticioni, "Juria gjykon, publiku vendos"



Me cilën nga konkurrentët keni më shumë miqësi?

Me të gjithë kam raporte shumë të mira.

Keni rivale në këtë garë, nisur edhe nga fakti që ky edicion i tretë është cilësuar si një nga spektaklet me konkurrentet më të bukura femra?

Po është e vërtetë që ka pasur femra shumë të bukura konkurrencte këtë vit, por kjo nuk përbën kriterin kryesor të konkurrimit. Për mua kërcimi është ai që duhet evidentuar dhe vlerësuar më tepër.

Elvana sapo të mbarojë Dancing, ju keni një tjetër mbartje të rëndësishëm ku do të merrni pjesë dhe që është "Balkan Music Award", ndiheni e emocionuar?

Vitin e kaluar kur kam performuar në Sofie, në "Balkan Music Award" me shumë artistë të tjerë të mëdhenj ballkanas si, Alexandra Stan, Ana Vissi, Akcent, Inna etj dhe jam ndjerë shumë krenare. Këtë vit nominimi i videos "Afër dhe Larg" me Provideo në 5 videot më të mira në Ballkan, duke përfshirë dhe Alexandra Stan dhe grupin nga të cilët janë të nominuar, më bën të ndihem dhe më shumë. Më emociononte pa masë përkrahja e publikut shqiptar duke votuar në çdo formë, që kjo këngë dhe video të fitonte. Jam e lumtur që kam mundësinë të përfaqësoj Shqipërinë, me punën time.

Do ti vazhdoni më tej bashkëpunimet tuaja me Pro video?

Pro video është një nga produksionet më të mira shqiptare, me një staf profesional. Ka treguar që kur bashkohet me "Thredoots", japin gjithmonë një produkt të suksesshëm. Unë jam shumë e kënaqur me çdo bashkëpunim timin, secili ka nga një sukses më vete. Video "Me ty" "Afër dhe Larg" dhe "Gjaku im".

I keni ndjekur videot e tjera pjesëmarrëse, si ju duken ato?

Padyshim konkurrimit më duket shumë i fortë, duke përmendur artiste si Alexandra

Stan, Lepa Brena, Severina, Manga.etj

Kujt i trembeni më shumë?

Për mua është arritje, që ndodhem e nominuar krahe këtyre artistëve dhe ky fakt vetëm më gëzon.

Ku qëndron e veçanta e klipit 'Afër dhe larg'?

dhe larg'?

Koncepti dhe kombinimi i vendodhjes së, xhirimit me fabulën e tekstit vjen shumë natyrshëm dhe i drejtëpërdrejt. Pa lenë pas dhe fotografinë dhe kualitetin e videos.

Nga të gjitha klipet dhe këngët tuaja cilën keni më të preferuar?

Do veçoja "Gjaku im" projektin tim më të fundit. Trajton një temë që ka shqetësuar vërtet mendjen dhe zemrën time. Jetojmë në një tokë me bukuritë rralla natyrore por të varfër dhe me shumë probleme dhe kemi kaluar kohë e situata të vështira. Këto dhe shumë faktorë të tjerë kanë bërë, që ne të jemi të pasigurt, të prirur drejt se keqes, mos të kemi besim në vetvete ndaj dhe vendosa të bëj një thirrje për të gjithë kombin shqiptar. Për të reflektuar dhe besuar në vetvete dhe në atë c'ka quhet "Gjaku jonë", gjak shqiptari. Besoj se ne jemi njerëz shumë të zgjuar dhe me zemër shumë të madhe ndaj mos të kemi frikë, nëse rritemi ngadalë, por të mendojmë sesi të rritemi dhe një ditë të arrijmë aty ku meritojmë të jemi. Dua të ndaj dhe një moment gjatë xhirimeve me publikun. Në këtë video kam interpretuar me aq ndjenjë saqë nga duart e lidhur me zinxhirë, të vërtetë hekuri ka dalë gjak realisht. Dhe kjo do të shihet në një "Making OFF", që është bërë dhe do të transmetohet shumë shpejt.

Do të merrni pjesë në ndonjë nga festivalet e rëndësishme shqiptare këtë vit ?

Deri tani nuk kam diçka në plan.

Jeni aktualisht "mbretëresha" në fuqi e Top Fest e keni ndjekur sa-

dopak, Top fest 9. Kujt ia uroni fitoren?

Shikoj që edhe këtë vit ka prurje muzikore shumë të mira dhe duket që disa prej tyre kanë zenë vend, në zemrat e publikut. Unë kam shumë të preferuara këtë vit si "Për mua je dashuri" Julka, "Fishezkjarrë" nga Besa, "Si shiu", Argjentina Ramosaj, "Ajo është ajo" nga Eric dhe superhiti "Mamica" i këngëtarit, Klajdi Haruni. Uroj që ashtu siç ndodhi vjet me mua fituesi, të jetë ai që ka mbështetur absolute të publikut!

Kohët e fundit ka qarkulluar në media lajmi, se ju do të jeni imazhi i "Tring Dixhital", sa të vërteta janë këto thashetheme?

Nuk ka asgjë të vërtetë.

Elvana keni një njeri që ju frymëzon në jetë?

Kam familjen time që e kam shumë të shtrënjtë dhe miq të mi të zemrës, që më japin dashuri çdo ditë.

Kujt ia dedikoni suksesin tuaj?

Falemideit Zotit, që në jetë më dha njerëzit, më të cilët ndaj çdo sukses dhe gëzim.

Duket se keni fituar një popullaritet të madh në publik, si është raportit juaj me fansat?

Fansat janë një shtyllë shumë e fortë e karrierës time. Falenderime të singqerta. Gjithmonë nuk do rreshtin së daluri nga zemra ime për ta.

E konsideroni veten një njeri me fat?

Kur shikoj familjen, miqtë që kam pranë, Shqipërinë e bukur ku jetoj, muzikën që bëj, për atë c'ka sot jam, po jam me fat!

Është e dashuruar Elvana Gjata?

E vërteta është që jam dashuruar me makinën time të re FIAT 500. Më bën të ndihem kaq mirë (qesh).

Cila është blerja juaj më e "çmendur"?

çdo blerje në vetvete është një çmenduri më vete (qesh). Sidomos kur janë me vlera të konsiderueshme.

Ku do ti kaloni pushimet verore?

Ende nuk kam vendosur asgjë, pasi bashkë me menaxherin tim Andy Dj, kemi një axhendë shumë impenjative, këtë verë me koncerte.



KLAJDI HARUNI

Pas "Mamicës", femrat më gjuajnë më shumë

Shfaqja surprizë, që do të "ndezë" Pallatin e Kongreseve

SUADA DACI

Nuk ka shumë kohë që është lanuar dhe është një këngët më të dëgjura dhe të klikuara të momentit. Bëhet fjalë për këngën "Mamica", e kthyer tashmë në fenomen, që këndohet nga Klajd Haruni, dhe që mban firmën e kompozitorit, Florian Mumajesi. Ndonëse është një këngëtar i ri, Haruni duket se do të radhitet përkrah emrave të njohur të muzikës së lehtë shqiptare. Në intervistën e tij të parë pas publikimit të "Mamicës", dhënë për suplementin THASH&THEM, 23 vjeçari nga Korça flet për pasionin e tij të hershëm për muzikën, si dhe për suksesin e arritur me këngën. Ndonëse merr pjesë për herë të dytë në Top Fest, Klajd Haruni këtë herë kaloi automatikisht në finalen e këtij kompeticioni. Ai premtën se kjo këngë në 3 qershor do ta ndez sallën e Pallatit të Kongreseve, me anë të surprizave që do të rezervojë në performancë. Duke folur për subjektin e këngës, ai sqaron se ajo është një këngë gazmore, që nuk ka për qëllim t'ironizojë aspak femrat, ndërsa shton se pas "Mamicës", femrat kanë filluar t'afrohen më shumë.

Klajd jeni zgjedhur automatikisht për të marr pjesë në finalen e Top Fest, si ndiheni?

Është një emocion shumë i madh për mua, duke qenë se jam një artist i ri. Në momentin kur Luana hapi zarfin, i cili kishte verdiktin e votave të publikut u ndjeva shumë i emocionuar dhe i gëzuar, pasi publiku është vlerësuesi më i mirë. Ndaj dhe i falenderoj të gjithë ata që më kanë votuar.

Do të këndoni për herë të parë live, në Pallatin e Kongreseve, ndjeni ndonjë përgjegjësi të veçantë?

Është hera e parë që këndoj live në "Pallatin e Kongreseve" dhe do të jetë një kënaqësi, por edhe përgjegjësi në të njëjtën kohë. Gjithsesi mendoj se do ta "dëgjim" Pallatin e Kongreseve, pasi do të ketë shumë surpriza në performancë (qesh).

Mund të na zbuloni ndonjë detaj? Surprizat ngelen surpriza (qesh).

Do të kemi ndonjë "Mamicë" në skenë bashkë me ju?

Ajo mbetet enigmë që do ta zbulojmë në finalen e Top Fest.

"Mamica", është kthyer tashmë në një fenomen, e menduat që do të kishte një sukses të tillë?

Këtë këngë që në tekstin e saj e kemi punuar të dy me Florin, shpeshherë duke pirë edhe ndonjë gotë dhe që kur kënga mori formën e saj fillestare, ne besuam se ajo do të bëjë një hit veror. Meqënëse dy këngët e mia të para kanë qenë balada, menduam të sillnim diçka ndryshe, një këngë që do të përcillte energji pozitive.

Pse mendoni që publiku e pëlqen?



Sepse iu përcjellë energji pozitive, alegrë dhe i bën të harrojnë sadopak stresin e akumuluar nga monotonia e përditshme.

Klajd, kujt i kushtohet "Mamica"?

Mamica është thjesht një fenomen, nuk ka person të veçantë, të gjitha vajzave në përgjithësi, qofshin të martuara ose jo (qesh).

Është një këngë që në një farë mënyre ironizon femrat, nuk menduat që suksesi mund t'iu kthejë në kontravers?

Kjo këngë nuk i ironizon femrat, por është një parodi e ngjashme me këngët e vjetra korçare. Po ta dëgjojmë këngën me vëmendje ajo flet për një "Mamicë", që siç e thashë edhe më sipër mund të jetë kushdo, e cila ka qmendum gjithë qytetin me bukurinë dhe hiret e saj. Në pjesën e parë të këngës i thurën lavde "Mamicës", ndërsa në pjesën e dytë, ky djali lodhet nga indiferenca e saj dhe do t'ia "thumboj" pak.

Cilin çmim do donit të fitoni?

Kur konkurrova në Top Fest, objektivi im ishte të arrija në finale. Por duke parë sesa shumë është pëlqyer dhe klikuar kënga nga publiku, do isha shumë i lumtur nëse do fitoja çmimin e publikut. Ky çmim do më shijonte më shumë se çdo çmim tjetër.

Mbani mend, ndonjë moment të veçantë gjatë klipit?

Klipi ka qenë një eksperiencë e bukur, shumë "funny" si dhe vet kënga. Kemi qeshur pa fund hipur majë karrotrecit. Kemi patur marrëdhënie shumë miqësore edhe me njerëzit në rrugë, që qeshnin me këngën.

Mendoni që "Mamica", ju bëri më të

njohur?

Patjetër që më ka bërë më të njohur. Kjo këngë ka qenë një katapultë shumë i madh për mua, duke parë që është klikuar rreth 800 mijë herë, që besoj se janë shumë për një artist të ri. Ajo është kudo nëpër rrjetet sociale, i në 2 makina nëpër të gjitha qytetet e Shqipërisë, dëgjon "Mamicën", luhet në shumë klube, pube e karaoke, madje edhe shumë banda e kanë bërë pjesë të repertorit të tyre (qesh).

Klajd, folëm për suksesin e "Mamicës", po kritikët e saj a kanë qenë të shumtë?

80% e komenteve kanë qenë pozitive, ndërsa ka patur edhe komente negative në aspektin se kjo këngë, tallet me femrat. Por siç u shprehja edhe më sipër kjo këngë nuk është konceptuar kështu, është thjesht një parodi që të ngre humorin.

Cilat janë projektet tuaja pas Top Fest?

Meqënëse "Mamica" është pëlqyer dhe dëgjuar kaq shumë kudo në Shqipëri, më motivon për të punuar dhe për të shpalosur projekte te reja. Por për momentin po shijoj suksesin e saj.

Do të jetë baladë kënga juaj e radhës?

Baladat i dashuroj shumë duke qenë se jam edhe nga Korça, të cilat ngajnë me serenatat korçare, që unë i dua pa fund. Besoj se projekti i ardhshëm mund të jetë diçka mes të dyjave (qesh).

Do të bashkëpunoni përsëri me Florin Mumajesin?

Që kur fillova ta marr seriozisht muzikën

bashkëpunimi im i parë ka qenë me Florin. I dyti erdhi si një duet me Florin me këngën "Lutem unë sot", e treta ishte "Mamica" por edhe produksioni i katërt e të tjera në vijim, do të mbajnë firmën e Florian Mumajesit. Unë kam një marrëdhënie të ngushtë me Florin dhe mendoj se bashkëpunimi i yni, do të jetë një "datë pa skadencë".

Si jeni takuar për herë të parë?

Mua më ka pikasur Flori. Të dy frekuentonim të njëjtin karaoke, ku unë këndoja për qejf dhe aty mes disa miqve tanë të përbashkët, u krijua lidhja me Florin.

Do të jeni pjesë e koncerteve nëpër Shqipëri, gjatë sezonit verorë?

Nga sot unë do të marr pjesë në koncertin tim të parë, që do të bëhet në Himarë me rastin e çeljes së sezonit të ri turistik. Do të jem përkrahë emrave të njohur të muzikës shqiptare si, Elvana Gjata, Julka, Flori Mumajesi, Andy Gramm, etj.

Çfarë është muzika për ju?

Muzika ka qenë pasioni im, që i vogël dhe vazhdon të jetë. Madje përpara se unë t'futesha kësaj rruge profesionalisht, mblidhesha gati 3 herë në javë me kitarë me shokët e mi dhe këndoja. Nuk e mendoj dot jetën pa muzikë dhe jam shumë i lumtur që kam gjetur njeriun e duhur për të bashkëpunuar e për të sjellë këngë të bukura që vetëm Flori di t'i bëjë.

Sa e vështirë për një artist të ri, i të futet në botën e muzikës?

Në fakt është shumë e vështirë të evidentohesh, por unë jam i lumtur se qysh në fillimet e mia, arrita të bashkëpunoj me njerëzit e duhur. Gjithë suksesin e arritur deri tani ia dedikoj Florit, sepse është përkushtuar më shumë seç duhet për çdo detaj.

Cili është këngëtari juaj i preferuar?

Më pëlqen Elvana Gjata. Për mua është një artiste që është shumë pak të quaj e kompletuar, por gjithashtu edhe një njeri i mrekullueshëm. Mund të them që më ka ndihmuar shumë në videoklipin tim të parë "Lutem unë sot".

Po familja sa ju mbështet, për këtë zgjedhje tuajën?

Familja ime e ka patur ëndërr që unë të vazhdoja rrugën e artit, pasi kur kam qenë i vogël më thonin që kisha shpirt artistit. Në çdo gëzim familjar kam qenë protagonist i kryesor, ndërsa kohë e fundit janë mërzhitur me mua, pasi nuk kalojë më shumë kohë pranë tyre (qesh).

Krahas angazhimeve tuaja në art, duam të dimë edhe për jetën tuaj private, jeni i lidhur?

(Qesh) Aktualisht jam beqar.

Në fakt me këngën e "Mamicës", vështirë t'iu afrohen vajzat?

Femrat më janë afruar gjithnjë. Por tani që doli dhe kënga e "Mamicës", do të jetë e kundërta e kësaj që thoni ju. Jo për gjë po ka filluar të ndihet "era" e detit (qesh).

Kë do donit të falendernit për suksesin e arritur deri tani?

Një falenderim i veçantë shkon për "Threedots Production", gjithashtu edhe për Provideo që ka realizuar të dy videoklipet e mia, "Absolut Style" që merret me lukun tim, si dhe çunat e performances, që do ta "ngrenë" në këmbë Pallatin e Kongreseve. Gjithashtu dua të falenderoj edhe suplementin "THASH&THEM", pasi është intervista e parë që jap në medianë e shkruar për "Mamicën" (qesh).

STELA & KLEVIS:

“Nudoja jonë” së shpejti në radio

Starton të martën në “Kiss Fm”, emisioni më i ri radiofonik “WoW”

SUADA DACI

Gjithçka që të tjerët kanë turp ta thonë në publik, por që është pjesë e pandashme e jetës së tyre. Personazhe publik që kërkojnë të flasin në lidhje me atë ç’ka shkruhet për ta por dhe gazetarë që mbrojnë atë çka shkruajnë, do të jenë disa nga temat që do të trajtohen në programin më të ri radiofonik, “Wow”. Kjo risi në mediat shqiptare do të ketë si protagonistë, dy moderatorët, Stela Kotri dhe Klevis Saliq. Emisioni do të startojë të martën në Kiss FM, dhe personazhi publik i parë, do të jetë reperi i njohur, Big Basta. Në një intervistë për suplementin THASH&THEM Stela dhe Klevis, premtojnë se do të sjellin një program të “çmendur”, ku dëgjuesit do

Çdo të martë në mbrëmje në orën 20:00 deri në 21:00 do të jetë në studio me në “NUDO” një personazh. Merreni si të doni ndaç nudo fizikisht, por ajo që na intereson është “NUDOJA” mendërisht

të njihen me të vërtetat “nudo” të personazheve publik.

Klevis dhe Stela, do të vini tashmë për dëgjuesit, me një program radiofonik, të quajtur “WoW”, na tregoni diçka më tepër?

Stela : Ouuu sa flet dhe ky Klevisi, i tregoi te gjitha. (qesh)

Klevis : Do jemi ndryshe, do të mundohemi të sjellim risi. Këtë herë do të jetë një emision i cili do të ketë të ftuar vip, stilist dhe do të flitet për shumë personazhe. Dëgjuesit do të kenë mundësi të dëgjojnë nga goja e vet vipave të vërtetat e tyre, ata do të përgjigjen një pyetësori jo të zakonshëm dhe do të selekcionojnë muzikë. Do të kemi për herë të parë një analizë të drejtëpërdrejtë të stilistëve shqiptar për veshjen e personazheve publik në Shqipëri. Por kujdes gjithçka do të jetë “WOW”.

Si ju lindi ideja për këtë emision?

Stela : Ideja për një emision sëbashku në fakt është e hershme duke qenë se jemi dhe miq të vjetër. Por më në fund vendosëm që të mos mbetet thjesht një ide, e morrëm seriozisht dhe nisëm punën duke e ideuar e me pas duke u konsultuar dhe me drejtuesit e radios, Kiss Fm.

Klevis : Thjesht. Kemi qenë një ditë në kafe dhe na kishte marr malli për radion. Sigurisht pas një bashkëpunimi të gjatë me Kiss Fm, ishte mundësia më e mirë në një radio, ku mbi të gjitha punohet me shuma pasion dhe ka hapësirë gjithmonë për gjëra të reja.

Stela si ndihesh kur punon me Klevisin, dhe ti Klevis kur punon me Stelën?



Stela Kotri dhe Klevis Saliq

Stela : Jemi gjithmonë të përfshirë nga batuta, humor dhe besoj se përveç seriozitetit ndaj punës, përballë publikut unë dhe Klevisi, do të shfaqemi më shumë si miq çapkenë sesa si dy moderator që janë bashkuar bashkë. Pastaj t’iu them një sekret...? Klevis është i padurueshëm kur bëhet fjalë për punë, është nervoz dhe ky është momenti që mua më pëlqen më shumë, sepse nervozizmin ja kthej në buzëqeshje... (qesh)

Klevis : Ne jemi miq prej vitesh. Nuk na ka njohur profesioni por njohjet miqësore. Duke qenë se gjithçka mes nesh është natyrale dhe nuk jemi të detyruar të rrimë me njëri-tjetrin dhe profesionalisht jemi rehat. Unë mendoj se një partner si Stela në një produksion, do ta donte çdo kush.

Çfarë ka të veçantë ai, ndryshe nga emisionet që ju drejtoni?

Stela : Është format i çmendur, të lejon të jesh vetvetja dhe mbi të gjitha jemi në dy (qesh).

Klevis : Ndryshe ka frymën. Të qenit të drejtëpërdrejtë dhe larg furcave. Është fryma që unë kam dhe në NEXT, gjithçka mbi ekran. Këtë herë do të jetë gjithçka në mikrofon.

Pse zgjodhët pikërisht radion si media për ta prezantuar atë?

Stela : Sepse televizionin tashmë e kemi, por mbi të gjitha sepse radio është magia që vetëm ai që e ka provuar di ta kuptoj. Vetëm në radio mund të jesh një eksploziv i vërtet ashtu siç do të.

Klevis : Sepse kemi kohë që

mendojmë të bëjmë diçka në radio. Në televizion jemi bashkë dhe pse në produksione të ndryshme. Na mungonte magia e radios dhe ndaj zgjodhëm radion. Pastaj kush rri dhe gjen rrobta, grimohet dhe merret me gjithçka. Këtë herë do jemi siç jemi pa grim dhe pa truk si në paraqitje, por dhe në përmbajtje të emisionit. (qesh)

Do të keni të ftuar çdo të martë nga një personazh publik?

Stela : Jo vetëm një personazh publik, por shumë personazhe, që secili prej tyre do të ketë pjesën e vet të rëndësishme.

Klevis : Çdo të martë në mbrëmje në orën 20:00 deri në 21:00 do të jetë në studio me në “NUDO” një personazh. Merreni si

të doni ndaç nudo fizikisht, por ajo që na intereson është “NUDOJA” mendërisht (qesh).

Mendoni që do të gjeni mbështetjen e tyre?

Stela : Absolutisht po, tashmë axhenda është përcaktuar, mbeten vetëm të martat për ti dëgjuar e për t’iu bërë juve të thoni “WOW”.

Klevis : Sigurisht. Janë të gjithë të gatshëm të përballen me “NUDO”, të paktën njëherë në jetën e tyre.

Do të kemi një “përleshje” vipash me gazetarët e mediave rozë ?

Stela : Nëse ju gazetarët jeni të gatshëm për përleshje me ta, pse jo? Tribuna është e hapur (qesh).

Klevis : Ne do të bëjmë të mundur thjesht ballafaqimin. Nëse gjërat shkruhen ashtu siç duhet dhe janë në rregull, nuk besoj se do ketë përleshje. Ne nuk duam të përleshim njëri, thjesht kjo gjë ngelet në dorë të gazetarëve dhe personazheve për ato që kanë thenë dhe s’kanë thenë.

Në krahun e kujt do të jeni ju, të kolegëve gazetarë apo të vipave ?

Stela : Në krahë të dëgjuesve. Edhe pse kam dyshime tek Klevis se mos ma merr vrulli i përleshjeve. Ju thashë, është i tmerrshëm ai, (qesh).

Klevis : Ne do të jemi në krahun e pasqyrit të gjërave siç janë me burime të sakta, me detaje dhe të vërteta. Ne do të jemi publiku që kërkon të di të vërtetat e atyre, që thuhën nga personazhet dhe shkruhen nga gazetarët.



Çdo të premte Lounge Bar, me gime 200L Lounge Drink, **Çdo të shtunë** Karaoke Night me Kelly, Blerina dhe Graciela

Çdo ditë një menu e pasur me gatime shqiptare dhe italiane.

Çdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shqiptare, dhe një pije.

Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

RRUGA "MUSTAFA MATOHITI", PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA

Cel. 0696070651



GRACIANO TAGANI:

Me Lorin tashmë shijojmë dhe ditën

Dëshironte të ishte lider dhe jo lodër

SUADA DACI

Pjesëmarrja në Big Brother ka qenë për të një nga eksperiencat më të bukura dhe çdo ditë në këtë reality e ka shijuar sikur të ishte dita e fundit. 19-vjeçari nga Tirana, Graciano Tagani, i cili ka lenë javën e shkuar shtëpinë më të famshme në Shqipëri, thotë se përveç momenteve të bukura është përballur edhe mjaft ashpër me banorët e shtëpisë. Balerini vlerëson se banori më falco brenda shtëpisë është Liam, i cili nuk di të përballtet me banorët në sy. Duke u ndalur te marrëdhënia e tij me Lorenën, një tjetër konkurrente e BB5, ai thotë se lidhja e tyre po ecën mirë, madje tani kanë filluar të shijojnë edhe ditën, jo vetëm natën siç ndodhte në BB.

Graciano, e prisnit të eleminoheshit nga BB?

Realisht nuk e prisja por nuk ishte fundi i botës.

Mendoni se Genta është një konkurren- te e fortë?

Mendoj se, është një konkurren- te e fortë nga vajzat e BB5, por kishte mundësinë të jepte më shumë në të gjitha aspektet.

Keni qenë edhe herë të tjera në no- minim, por si ishte kjo javë e fundit për ju?

Çuditërisht do të thoja nga më të qetat dhe që e kam shijuar më shumë. Fakti që kam qenë në nominim nuk përbënte ndryshim nga jav- ët e tjera, sepse kam qenë njësoj gjatë gjithë kohës. Unë çdo ditë shtëpi, e jetoja si të ishte e fundit.

Kë takuat menjëherë sa dolët nga BB?

Personat e parë që takova ishin mami, shoku im i ngushtë Gledi dhe çuditërisht tatën e Erjonit (qesh).

Po me Lorenën u takuat?

Po, por edhe po mos të doja ta takoja, nuk kisha ku të shkoja se ishte në studio bashkë me të eliminuarit e tjerë të BB5 (qesh).

Si po vazhdon lidhja juaj tani që jemi jashtë?

Them se po shkon mirë. Tani jemi më të përqëndruar tek njëri- tjetri dhe ka filluar të na shijojë edhe dita.

Si ju duket Lorena jashtë sh- tëpisë?

Në tip njësoj si brenda saj, por për disa gjëra të tjera ndryshon. Qenka më ak- tive jashtë saj.

Do të jetoni bashkë?

Eh h h ikën ato kohëra (

qesh), gjithësi të ardhmes nuk i dihet.

Le të kthehemi te BB, cili nga banorët mendoni se do ta fitojë këtë reality show?

Nuk dua të jap një emër të caktuar. Fakti që nuk jam unë nuk më intereson se kush do të jetë fituesi. Për mua është njësoj kushdo që t'a fitojë.

Pse nuk u përfshit në asnjë nga gru- pet e shtëpisë?

Sepse më pëlqen më shumë të jem lider sesa "lodër", që përdoren nga grupet që janë aty brenda. Fakti që unë nuk u përfshiva në asnjë nga grupet e tregoi fare mirë këtë gjë.

Keni patur debate të forta me dy lideret e grupeve, qoftë me Liamin qoftë me Ermalin, cili ishte shkaku?

Po e nis me Liamin. Kam patur debate të forta me të, sepse nuk është aspak real aty brenda. Gjithçka e bënte mbrapa kraheve dhe ishte personi më i pabesë, që kam njohur deri më sot. Arsyet këto të cilat më bënin që të debatoja me atë, por ai duke mos u përballuar dot situatën e kalonte debatin në ofendime personale familjare dhe shoqërore. Ndërsa me Ermalin marrëdhënia ka qenë më miqë-

E them me krenari që isha banori i vetëm në shtëpinë e BB5 që më janë bërë surprizat më të bukura, që nga dita e parë kur hyra dhe deri në fund



sore. Debatet vinin kryesisht si pasojë e mendimeve të kundërta që kishim për çështje të ndryshme.

I shikon si dy nga konkurrentët e fortë të këtij spektakli?

Jo vetëm këta të dy.

Po marrëdhënia juaj me Françeskën si ka qenë, pasi ju jeni moshatar?

Relativisht e mirë. Si moshatar që ishim kuptoheshim shumë mirë si unë dhe ajo. Madje dua të them që dhe pse ishim më të vegjëlit në moshë, kemi qenë pikërisht ne që jemi përballur me ata që ju i cilësoni "si më të fortët".

Cili ka qenë momenti më i bukur brenda shtëpisë?

E them me krenari që isha banori i vetëm në shtëpinë e BB5 që më janë bërë surprizat më të bukura, që nga dita e parë kur hyra dhe deri në fund. Sigurisht që këto do mbeten gjatë në memorien time. Siç e thashë edhe më lartë, e kam jetuar çdo ditë në maksimum.

U takuat me babanë tuaj, pasi dolët nga BB?

Jo sepse im atë jeton në Itali, por ka qenë personi i parë, që kam komunikuar nëpërmjet telefonit.

Çfarë do t'iu mungojë nga kjo ekspe- riençë?

Gjithçka... madje dhe gjërat jo të këndshme, që mund të kem përjetuar aty brenda.

Me çfarë po merreni aktualisht?

Nxënësit e mi mezi po e prisnin daljen time, që unë të vazhdoja punën. Madje që ditën e parë që dola pata dhe shumë regjistrime në palestrenë "Graciano dance". Por gjithësi puna ime fillon javës që vjen. Kjo javë vetëm pushime.

Mendoni që BB, do të jetë një tram- polinë e mirë, drejt artit?

Absolutisht që po dhe kjo ishte arsyeja kryesore që unë mora pjesë në BB5. Frytet e para jam duke i shijuar, që në këto ditë të para.

Me thoni me një përkufizim, ç'mendim keni banorët e BB5?

Ermali - Magazinieri i shtëpisë pasi është ai që bën inventarin për çdo gjë.

Françeska- Është Miss-i i shtëpisë e cila di ti bëj ballë çdo situatë.

Liami - Njeriu më falco dhe i pabesë, që kam njohur ndonjëherë.

Arbri - inteligjent i drejtpërdrejtë dhe më shumë sens humori

Gerta - një masazhatore perfekte

Dritani - djalë me norma dhe i drejtë

Genta - kacavidhe (qesh)

Cilin nga banorët e BB, konsideroni si mikun tuaj më të mirë?

Nuk kam vetëm një por disa duke filluar nga Edgari, Anila, Ola, Albulena, Erjoni, Genta uhhh sh shumë.

Në foto: Graciano Tagani





Votat e publikut dhe të jurisë bënë që Seldi të ndërpriste garën pas herës së gjashtë që ai dilte në "Dance off". Në fund të spektaklit këngëtar i performoi këngën "Shqipëri oj nana ime", duke përshëndetur publikun

DANCING WITH THE STARS

Seldi Qalliu lë garën pas 6 "Dance off"

Protagonistët e spektaklit të vallëzimit relaksohen pas kuintave

Spektakli "Dancing With The Stars" ka mbytur edhe këtë javë një mbrëmje të mbushur me emocione, vallëzime muzikë dhe momente plot gjallëri. Si çdo të enjte konkurentët e mbetur kanë vijuar garën drejt çmimit të madh, duke performuar zhanre të ndryshme kërcimi. Kisja e kësaj e jave ishin bazat muzikore tërësisht me këngë shqiptare. Me anë të tyre u krijua gjithashtu edhe një atmosferë mjaft patriotike. Të ftuar special të mbrëmjes ishin këngëtarë të muzikës të lehtë shqiptare, si Irma Libohova, Sidrit Bejleri, Jonida Maliqi dhe Altin Goci, të cilët shprehën opinionet dhe vlerësimet e tyre për spektaklin. Këngëtarja e famshme dhe e njohur veçanërisht për ndryshimet e shumta në pamjen e saj Jonida Maliqi është shprehur se, "do të doja t'i përgëzoja të gjithë artistët ashtu sikurse dhe ko-reografët, Ardi Asllanin për kostumografinë, etj".



Gjithashtu këngëtarja e mirënjohur e muzikës shqiptare Irma Libohova performoi e shoqëruar nga artisti i madh Agim Krajka në piano, këngë nga repertori i saj ndër vite. Gjatë konkurimit ethe dhe garës ishin mjaft të forta dhe sidomos në castet e ndarjes së pikëve nga juria. Këngëtarja dhe moderatorja e njohur Zhaku nuk kursen puthjet për anëtarët e jurisë pas dhënies së pikëve prej tyre. Sipas tyre ajo ka ekzekutuar një performancë mjaft të mirë, duke u vlerësuar me pikë të larta. Ndërkohë në këtë puntantë i erdhi fundi rrugëtimit të këngëtarit Seldi Qalliu. Ai shkoi në "Dance off", së bashku me Afërdita Dreshaj,

por mesa duket performanca e tij nuk i siguroi qëndrimin në garë edhe për një javë tjetër. Votat e publikut dhe të jurisë bënë që Seldi të ndërpriste garën pas herës së gjashtë që ai dilte në "Dance off". Në fund të spektaklit këngëtar i performoi këngën "Shqipëri oj nana ime", duke përshëndetur publikun. Ndërkohë si çdo javë nuk mund të mungojnë edhe prapaskenat e këtij spektakli ku protagonistët na shfaqen ndryshe dhe shprehin më qartë emocionet e tyre. Ami dhe Ermali ndodhen së bashku në ambientet e Gold Room,



, ku ajo ç'ka bie më shumë në sy është fustani mjaft i këndshëm i saj. Më pas prezantuesja simpatike ka vendosur të relaksohet, duke marrë pak ajër nga një prej dritareve. Enada Hoxha dhe Ardi Asllani duken mjaft të përqëndruar në bisedën e tyre rreth spektaklit dhe balerina mban në dorë një bllok për të sistemuar më mirë idetë për shfaqjen. Afërdita Dreshaj së bashku me Vedat Ademin dhe Enada Hoxhën, kanë pushuar në të njëjtin kollkut i cili duket të jetë mjaft komod. Pjesëtari i jurisë Alfred Kaçinari, producentja e spektaklit, Holta Dulaku dhe kostumografi Ardi Asllani duket se po zhvillojnë një bisedë të këndshme ndërmjet tyre. Ndërkohë prezantuesi Ermal Mamaqi është duke u relaksuar e njëkohësisht përgatitur për të transmetimin live të spektaklit. Javët e ardhshme të këtij formati televiziv priten të jenë edhe më të ethshme, pasi numri i garuesve sa vjen e reduktohet dhe konkurrenca për çmimin final shtohet edhe më shumë.

PUTHJA NË BB

Genta dhe Françeska puthen në buzë



Duket se është një foto shumë provokuese e realizuar nga dy konkurrentet e Big Brother Albania 5, Genta dhe Françeska. Në fillim ka marr ngjyra shakaje, por vajzat duket të kenë përjetuar edhe një eksperiencë të veçantë. Kjo foto është komentuar gjatë edhe në rrjetet sociale. Shumë prej ndjekëse në Facebook,

kanë nënvizuar se vajzat duhet të marrin pjesë në paradën e homoseksualëve, që do të zhvillohet në 17 maj në Tiranë, por ka edhe nga ata që thonë se Gentës i pëlqen të jetë në qëndër të vëmendjes, me të tilla mënyra. Të dyja konkurrentet e BB, janë të evidentuar më se miri nga publiku me lojën që po bëjnë në BB.



DITËLINDJA

Arbër Çepani, feston 25 vjetorin e lindjes

Ftuesi i edicionit të parë të Big Brother Albania, Arbër Çepani ka festuar 25 vjetorin e tij të lindjes. Familjarë dhe miq të ngushtë, të ish konkurrentit të BB, i kanë organizuar atij një festë surprizë, për këtë ditë të veçantë.

Ajo që të binte në sy ishte një tortë gjigande, ku shkruhej "Arbër edhe 100", si dhe një balerinë belly dancing, e cila ka kërcyer posaçërisht për Arbrin. Të pranishëm në festën e ditëlindjes kanë qenë ish-banorë të BB, si

Poli, Anjeza, Juna, Julinda, Jonida, pra miqtë e tij më të ngushtë të këtij reality show. Një tjetër e ftuar që ka rënë në sy, ka qenë edhe këngëtarja Rezarta Shkurta sëbashku me bashkëshortin e saj, Ermal Hoxha.



PIRRO ÇAKO

Nuk ndahet asnjë çast nga Sisi

Kantautori i njohur Pirro Çako prej disa kohësh ka nisur një lidhje të re dashurie, me një vajzë të quajtur Sesilia. Këto kohë këngëtari ka qenë mjaft i zënë nëpër koncerte. Megjithatë kjo nuk e ka penguar atë që të qëndrojë në krah të Sisit. Ai e merr të dashurën në çdo aktivitet, ku merr pjesë dhe tek të cilat arrin të fitojë rreth 1 mijë euro për çdo koncert.



KASTRO ZIZO


Bëhet baba për herë të dytë me Nian

Këngëtari, Klevis Bega i njohur ndryshe si Kastro Zizo, është bërë baba për herë të dytë. Gëzimin e një lajmi të tillë ai e

ka ndarë edhe me fansat e tij në Facebook. "Sot këtë ditë të bukur 11 maji natyra, zoti, Erleta më dhuruan vajzën më të bukur në botë. Nia Bega. Mirëserdhe në jetë bukurshija ime!"-është shprehur Kastro Zizo. Nia është fëmija i dytë i këngëtarit e lindur nga martesë e tij e dytë me Erletën. Nga martesë e tij e parë ai ka dhe një djalë të quajtur Dankan.


KËNGËTARJA

Çiljeta ndahet nga Aleksandri, nuk e pranon



Prej disa kohësh Çiljeta është në një lidhje me një djalë të quajtur, Aleksandër. Megjithatë prej disa ditësh kanë qarkulluar zëra për ndarjen e çiftit. Në rrjetin social Facebook Çiljeta nuk është më në një lidhje me Aleksandrin, madje miq të afërt të këngëtares kanë

pohuar një fakt të tillë. E kontaktuar me telefon nga THASH&THEM, këngëtarja nuk ka preferuar të flas për këtë çështje. Nuk e dimë se çdo të bëhet me tatuazhin që Çiljeta i ka dedikuar atij, por diçka dihet me siguri që ajo i është përkushtuar biznesit dhe projekteve muzikore.



ISH-BASHKËSHORTI I TUNËS

Rilind Reka harron Tunën, martohet për herë të dytë

Ish-bashkëshorti i këngëtares kosovare Tuna, Rilind Reka, do t'i propozojë për martesë të dashurës së

tij aktuale, Besa Haxhaj. Çifti ndodhet prej kohësh në Itali, ku aty pritet të kurorëzojnë me martesë lidhjen e tyre të

dashurisë. Rilindi dhe Tuna kanë qenë të martuar në prill të 2011 dhe pas një muaji janë ndarë. Shkaqet e divorcit të tyre nuk janë bërë të ditura, as nga këngëtarja, as nga Reka. Ndërkohë Tuna pritet të sjellë një klip të ri dhe është duke punuar për albumin muzikor.

Sigurimet shëndetësore, në skemë edhe spitalet private

Në skemën e re të sigurimeve shëndetësore mund të bëjnë pjesë edhe privatët. Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor, do të mund të blejë shërbime të ndryshme, që nuk ofrohen nga sistemi publik edhe nga klinikat, spitalet apo laboratorët privatë. Drejtoresha e ISKSH-së, Elvana Hana, duke folur për ligjin e ri ka deklaruar se një tjetër pikë tjetër e

rëndësishme që parashikon drafti i ri, ka të bëjë me rregullat që do të vendosë Fondi për mbledhjen dhe shpërndarjen e burimeve financiare për dhënësit e shërbimit shëndetësor. Administrimi i skemës së financimit do të bëhet nëpërmjet: regjistrimit dhe identifikimit të kontribuesve, procedurave të qarta të kontraktimit të dhënësve të shërbimit,

pagesës së dhënësve të shërbimit vetëm për ato shërbime që u janë ofruar realisht pacientëve, procedurave të qarta të pagesave dhe verifikimit të kërkesave për pagesë. "Për herë të parë, futen elementet e tregut në shëndetësi, pasi ligji i ri parashikon mundësinë e kontraktimit edhe të dhënësve private të shërbimeve shëndetësore", - tha drejtoresha e ISKSH-së, Elvana Hana.

FOTOT/ Ja situata reale e spitalit publik të Tiranës

OBSH: Shëndetësia, e bekuar që ka Berishën

Drejtorja Zsuzsanna Jakab "mahnitet" nga arritjet

Lajmi

Kryeministri Berisha, e ka mahnitur drejtoreshën rajonale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Zsuzsanna Jakab, teksa i ka renditur hapat gjigantë që ka hedhur shëndetësia shqiptare këto vitet e fundit.

TIRANE

ESMERALDA KETA

Në konferencën e djeshme të organi zuar nga ministria e Shëndetësisë dhe OBSH për "Politikat Shëndetësore në Shqipëri - Strategjia e OBSH për shëndetin deri në vitin 2020, shëndeti në të gjitha politikat", kryeministri Berisha ka arritur të lërë gojëhapur përfaqësuesen e lartë të OBSH. Ai i ka thënë drejtoreshës rajonale të OBSH, Jakab, se vdekshmëria foshnjore ka arritur të ulët në një numër një shifror, por me sa duket ka harruar t'i thotë asaj se fqinjët tanë të rajonit e kanë këtë shifër shumë më të ulët. Kështu, nëse për vendin tonë regjistrohen 8.7 vdekje për 1.000 lindje, në spitalet e fqinjëve tanë helenë regjistrohen vetëm 3 vdekje për çdo 1.000 lindje, ndërsa Serbia regjistron 6 vdekje foshnjash për çdo 1.000 lindje. Një tjetër arritje është edhe vdekshmëria amtare, ku vendi ynë, sigurisht ka bërë hapa përpara, por ama regjistron 8.1 vdekje të nënave për çdo 100 mijë lindje të gjalla, ndërkohë që në Itali kjo shifër është vetëm 3.9 vdekje. Gjatë konferencës Berisha ka deklaruar se "erdhëm nga një sistem dizastër në këtë plan, pa menaxhim nuk ka sukses. Nuk përballohen nevojat duke rritur gjithnjë buxhetin, ato përballohen duke shfrytëzuar në mënyrën më racionale fondet e disponueshme, kërkohet plejadë e re menaxherësh", - ka deklaruar Berisha. Dhe duket se fjalët e Berishës e kanë bërë efektin që ai dëshiron, pasi drejtoresha rajonale e OBSH, e cila ka mbërritur për vizitë në vendin tonë, vetëm dy ditë më parë, se ka fshehur "xhelozinë" në kujdesin që kryeministri ynë, Berisha tregon për sistemin tonë shëndetësor. "Ministri Vasili ka një rol të rëndësishëm drejtues në forcimin e sistemit shëndetësor, por gjithashtu dua t'ju them se jeni të bekuar që keni një kryemi-



Kryeministri Berisha, ministri Petrit Vasili dhe përfaqësuesja e OBSH, Zsuzsanna Jakab

nistrë që i jep mbështetje të gjitha çështjeve shëndetësore dhe një përkujdesje të veçantë aspekteve shëndetësore", - ka deklaruar drejtoresha rajonale e OBSH, Zsuzsanna Jakab, e cila ka shtuar se sistemi ynë i vaksinimit, që për hir të së vërtetës e kemi shumë të mirë, duhet të merret si model edhe nga vendet e tjera të Evropës.

REALITETI

Por duket se Berisha dhe ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili, të cilët i kanë folur për arritjet e sistemit tonë shëndetësor, kanë harruar t'i tregojnë përfaqësueses së lartë të OBSH-së realitetin e vërtetë të spitaleve tona. Ata e kanë çuar zonjën Jakab për të vendosur një tullë për ndërtimin e aksel-

eratorit linear në QSUT, por nuk e futën të shikojë kushtet skandaloze në të cilët shtrohen pacientët e kirurgjisë së përgjithshme, godinë e cila është ndërtuar që në vitet 1940 dhe nuk është lyer më as me gëlqere që pas viteve 90-të, në pritje për t'u shembur. Gjithashtu ata kanë harruar t'i thonë asaj se në Qendrën tonë spitalore Universitare, jo vetëm që nuk ka as medikamentet më elementare, por madje nuk ka as banjot dhe njerëzit urinojnë brenda në korridorin e spitalit, apo të të pikojë tavani i katit të katërt, ndërkohë që godina është 5-katëshe, pasi firma që bëri rikonstruksionin pak kohë më parë "harroi" të vinte tubin e shkarkimit të ujërave të shiut.



Në foto: Dhoma në katin e katërt të Onkologjikut, të cilës nga lagështira i ra edhe tavani, pasi firma që bëri rikonstruksionin nuk vendosi tubat e shkarkimit të ujit (poshtë) Korridori i katit të parë të Onkologjikut, ka pacientët kanë urinuar



LAJME SHKURT

Elbasan, 400 të verbër në protestë për ndihmat

Rreth 400 të verbër të qarkut të Elbasanit kanë protestuar dje përpara prefekturës së këtij qarku për të kërkuar më shumë të drejta. Madje ata nuk kanë ngurruar ta quajnë ministrinë e Punëve Sociale në ministri të Punëve fatkeqe, pasi ajo po i lufton hapur këtë shtresë shumë në nevojë të shoqërisë. "Ministri Ksera do të mbahet mend si ministri-autori i të zezave tona. Me iniciativën e tij u ndërpre indeksimi i pagesës së verbërisë me pagën minimale, u përjashtuam nga ndihma ekonomike dhe së fundi fshitë nga ligji programet sociale mbështetëse", - kanë deklaruar protestuesit duke kërkuar që të marrin fund këto politika diskriminuese.

Bashkia e Tiranës, punë për 400 të sapodiplomuar

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Lutzim Basha, nënshkroi një marrëveshje me Dhomën e Tregtisë së Tiranës për punësimin e rreth 400 të rinjve nga bizneset e kryeqytetit gjatë tre muajve të ardhshëm. Marrëveshja parashikon punësimin e të paktën dy vetëve në 200 biznese që janë pjesë e këtij grupimi ekonomik. Në fjalën e tij, kryebashkiaku Basha u shpreh se, do të ngrihet edhe një qendër e trajnimit profesional për të ndihmuar në kualifikimin e të rinjve dhe për të rritur shanset e tyre në tregun e punës. Ndër të tjera, Basha tha se, do të vazhdojë mbështetja për sipërmarrjen private dhe krijimi i kushteve lehtësuese për investime në qytet.

Minibashkia nr.6, aksion për pastrimin e ambientit

Njësi bashkiake nr 6 në kryeqytet është bërë iniciatore e nismës "Dita e qytetarëve", ku banorët e zonës janë angazhuar për pastrimin e Kombinatit nga plehtrat. Administrata e kësaj njësie, qytetarë të thjeshtë por edhe nxënësit ia kanë dedikuar ditën pastrimit të zonës, duke lëshuar kështu apelin për mbrojtjen e mjedisit. Kreu i njësisë, Krenar Cenollari tha se ky është vetëm fillimi i projekteve të ndërmarrja për pastrimin e Kombinatit. "Dita e qytetarëve" do të mbledhë një herë në muaj banorët e njësisë 6 për pastrimin e ambientit.

Shfrytëzimi pa kriter

Bimët mjekësore drejt zhdukjes

TIRANE

Shumë bimë mjekësore që rriten në Shtetet e Bashkuara të Amerikës po shkojnë drejt zhdukjes për shkak të shfrytëzimit të tyre pa kriter. Shqetësimi është shprehur nga biznesmenët shqiptarë që veprojnë në industrinë e bimëve mjekësore. Në konferencën e tyre të parë, ata kërkuar disa lehtësira fiskale, por dhe vendosjen në ligj të masa ndëshkuese për dëmtuesit. "Të ndërhyhet me ligj, me një mbështetje që kjo t'i jepet fund. Mendoj që vitin tjetër disa zona më të rrezikuara t'i kalojmë në grada, të cilat për një vit apo dy vjet, në konsultë me specialistët e mirëfilltë të shtohet dhe të mos shkatër-

rohet", - ka deklaruar Filip Gjoka, kryetar i APCPEM. Ndërkohë që ministri i Mjedisit, Fatmir Mediu i pranishëm

Lajmi

Industria e bimëve mjekësore ka arritur të futet në tregun evropian dhe atë amerikan, ndërsa të ardhurat që ajo sjell në ekonominë tonë llogariten në rreth 50 milionë dollarë në vit. Por drejtuesit e kësaj shoqate kanë ngritur alarmin se disa prej tyre rrezikojnë të zhduken për shkak të ndërhyrjes pa kriter

në aktivitet siguroi mbështetjen e qeverisë, për këtë industri, ndërsa iu përgjigj edhe shqetësimit të sipërmarrësve se nuk kanë gjetur bashkëpunimin e disa drejtuesve vendorë, të cilët siç u tha, sillen si pronarë të pyjeve që ata administrojnë. "Unë atë dëshiroj, që ata të sillen si pronarë, por të sillen si pronarë të ligjshëm, që të kuptojnë që çdo gjë duhet bërë në bazë të ligjit dhe të rregullit. Do të ishte e rëndësishme dhe e nevojshme që bashkë me Drejtorinë e Përgjithshme të pyjeve të vendosim setin e rregullave për shfrytëzimin dhe detyrimeve që të mos tejkalojnë planin e menaxhimit apo kompetencave të tyre", - ka deklaruar ministri Fatmir Mediu.



Debati

AKADEMIA E SHKENCAVE Reagimi i akademikut Myzafer Korkuti erdhi menjëherë pas artikullit të botuar në gazetën tonë nga akademiku R. Memushaj: "QSA, reforma që shkatërroi institutet shkencore". Nëpërmjet intervistës që ka dhënë për Shqiptarja.com zbulojmë se çfarë fshihet tej fasadës së Akademisë së Shkencave

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Ndarja në institute është dëmi më i madh shkencës së albanologjisë shqiptare", dëshmon në intervistën për Shqiptarja.com, vetë nënkryetari i këtij institucioni, akademiku Myzafer Korkuti. Ndërsa rrëfen për atë çfarë ndodhi konkretisht me zhbërjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nënkryetari i ASHSH-së nuk nguron të dëshmojë edhe shkatërrimin përfundimtar të saj. "Ju pyesin pse s'ka kërkitime shkencore, kur akademisë i është prishur çatia", shprehet i revoltuar akademiku Korkuti, ndërsa konfirmon edhe faktin që është shkatërruar dhe ka humbur pasuria shkencore e kësaj akademie. "Zhduken arkivat e Akademisë së Shkencave në kohë paqeje, në kohë demokracie, kur dihet që edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore shtetet mbrojtën para së gjithash arkivat". Reagimi i akademikut Myzafer Korkuti erdhi menjëherë pas artikullit të botuar në gazetën tonë nga akademiku Rami Memushaj: "QSA, reforma që shkatërroi institutet shkencore". Problemet nxjerrin krye sërisht pas polemikave që tronditën Akademinë e Shkencave të Shqipërisë katër vjet më parë. Dëshmti të kësaj reforme, sipas akademikëve, zë fill pas shkëputjes nga Akademia e Shkencave të disa instituteve, ku disa u zhdukën dhe ato që merren me gjuhën, historinë dhe kulturën kombëtare u bashkuan te "Qendra e Studimeve Albanologjike". Përfundimisht të dy akademikët, nënkryetari i ASHSH-së, zoti Korkuti dhe prof.Dr. Memushi e kanë quajtur shkatërrimtare reformën e dirigjuar nga qeveria. Se çfarë fshihet pas këtij shkatërrimi, akademiku Myzafer Korkuti e shpjegon në intervistën e mëposhtme:

Zoti Korkuti, si ka rezultuar në të vërtetë reforma që ndau prej Akademisë së Shkencave QSA-në dhe institutet e tjera?

-Reforma që u bë në Akademinë e Shkencave është dhe mbetet një nga çështjet që kërkon zgjidhje dhe ato mendime që janë thënë nga të gjithë akademikët, punonjësit shkencor janë vërtetuar se kanë qenë plotësisht të drejta. Prishja e strukturës së Akademisë me institutet është dëmi më i madh që i është bërë shkencës së albanologjisë shqiptare. Përvoja e këtyre viteve, pasi u zbatua reforma e tregoi katërcipërisht këtë gjë. Tani mbetet vetëm që: një qeveri me mend në kokë, një qeveri me logjikë, një qeveri që mbështet kërkimin shkencor ta korrigojë sa më parë këtë.


A ruhet ende rregullorja që punonjësit shkencorë të japin 30 për qind të kohës mësim e 70 për qind të jenë në kërkim shkencor?



Në foto: Akademia e Shkencave

MYZAFER KORKUTI: Politika duhet të qëndrojë larg akademisë, duam pavarësi

Si e shkatërroi Akademinë e Shkencave reforma e para katër vjetëve



Në foto: Myzafer Korkuti

-Ju kërkonte të dini disa gjëra të përgjithshme, por pa një punë shkencore, pa një kërkim nuk mund të ngrihet çatia. Këtu themeli i kësaj pune duhet të fillojë nga baza. Të ruhen institutet dhe themelet e kërkimit shkencor bashkë me punën pedagogjike dhe rregulli ka qenë 70 për qind të jetë

Ju shkonte të shikoni se në ç'gjendje janë arkivat, kartoteka e Institutit të Gjuhësisë. Shikoni në ç' kushte janë muzetë që ruajnë vlerat arkeologjike

punë shkencore dhe 20-30 për qind të jesh pedagog i jashtëm. Behet fjalë për ata që japin leksione në universitetet. Kjo ishte tradita.

Çfarë po bëhet aktualisht me proceset e kërkimit?

-Këtu nuk ka plane. Nuk ka perspektivë të saktë për këtë punë. Këtu duhet filluar nga a e para që të ngresh departamentin përkatës. Këtu gjëra duhet të vijnë shkallë-shkallë. Këtu janë gjëra shumë të njohura për ata që merren me këtë punë. Mua më vjen keq që shprehem vetë për këtë punë.

Po për fatin e librave të kërkuesve të vjetër kush in-

teresohet. Arkivat nuk janë të mbajtura me kujdes. A krijon kjo një handikap për kërkuesit e rinj?

-Unë di që kur filloi Lufta e Dytë Botërore ato shtete që ishin vërtet serioze, ndër masat e para që morën: siguruan arkivatet e shtetit, në kohë lufte po flas. Tani në një periudhë paqeje, demokracie, janë prishur arkivat. Ju shkonte të shikoni se në ç' gjendje janë arkivat, kartoteka e Institutit të Gjuhësisë. Shikoni në ç' kushte janë muzetë që ruajnë vlerat arkeologjike. Atëherë çdo të ketë brezi i ri, mbi ç' arkiva do të studiojë.

Këto arkiva në cilën masë janë shpërbërë?

Këtu ka një varg problemesh. Nuk është vetëm problemi i arkivave. Është edhe problemi i kuadrit të ri. Nuk vjen me profilin e duhur që të punojë në këto institucione shkencore. Pra, duhet ta seleksionosh që në fakultet këtë kuadër, pastaj ti japësh mundësi atij të përgatitët shkallë-shkallë dhe të ruajë lidhjet e kërkimeve që kanë bërë brezat e mëparshëm. Këtu është krijuar një boshllëk i trashëgimisë së lidhjeve nga kuadri i vjetër me kuadrin e ri. S'ka qenë kurrë në krizë më të madhe se sot kërkimi albanologjik në Shqipëri. Kërkime albanologjike bëjnë edhe vendet e tjera dhe shtetet e tjera. Ne që jemi

mëma e albanologjisë, nuk bëjmë asnjë kërkim

Po kush duhet t'i bëjë këto punë?

Janë të përcaktuara, ka rregulla, ligje ku thuhet se kush duhet t'i bëjë. Ju kërkonte t'i themi nga e para, ç'vlerë ka kjo tani. Instituti i Arkeologjisë ku unë kam drejtuar për 20 vjet kishte të drejtën të firmoste për kërkimet shkencore. Pas një plani afatmesëm ose afatgjatë. Që këtu filon problemi. Domethënë, arkeologët, specialistët e departamenteve bëjnë plane, bëjnë projekte dhe mbi bazën e tyre ecën puna. Instituti i Albanologjisë nuk ka të drejtën sot të bëjë një marrëveshje me të huajt, s'ka të drejtën e firmës, sepse nuk është i pavarur, nuk është institucion, është brenda kuadrit të studimeve albanologjike, i është hequr pavarësia. Specialistët, arkeologët e Shqipërisë që bashkohen me këshillin shkencor duhet të vendosin, se nuk ka njeri tjetër të vendos për këto, ashtu siç vendos sot Instituti i Monumenteve për Projekte. Kanë qenë të ndara këto punë.

Zoti Korkuti, kur ngrihen probleme ju dhe akademikët e tjerë politika nuk reagon asnjëherë, pavarësisht akuzave në drejtim të saj. Pse shteti e bënë veshin shurdh?


-Ka një rregull: me kërkimet arkeologjike duhet të merren vetëm arkeologët; për problemet e historisë duhet të vendosin vetëm historianët. Në rast se futet politika në shumë raste, atëherë kërkimi shkencor është prishur, i ka rënë vlera. Politika të bëjë punën e vet. Është i pavarur kërkimi shkencor. Neve na mungon pavarësia e kërkimit shkencor, sepse kemi të bëjmë me mjete financiare. Politika kur nuk do të japë jap mundësinë për të qenë i pavarur në kërkimet akademike, nuk jep mjete financiare.

Ju përfaqësoheni me ndonjë akademik në Kuvend që të ngrejë zërin për këto probleme?

-Nuk ka nevojë të jetë akademiku në Kuvend. Akademia ka asamblenë e vet. Asambleja e Akademisë është organi më i lartë. Në tërë botën për të gjitha gjërat vendos Asambleja Akademike. Shtetit i them jepi mundësi të dëgjohej mendimi i akademikëve dhe jepi mundësi të realizojnë veprat që duhet.

Së fundi, me çfarë po merret akademiku Myzafer Korkuti?

-Tani është rasti i 100- vjetorit të pavarësisë dhe unë po përipiqem të botojë, po gjeta mjete financiare, rreth 30 artikuj në shtypin arkeologjik ndërkombëtar në një vëllim më vete. Janë rreth 500 faqe në gjuhë të huaj dhe dua ta prezantojë gjithë kontributin tim në këtë 40-vjetor të ASHSH-së. Kjo është puna ime personale, ndërsa të gjithë bashkë ne kemi menduar të lartësojmë figurat e ndritura të pavarësisë, të Ismail Qemalit dhe atyre që kontribuan për të.



ZBAVITJE

[SHQIPTARJA] *çuditëse*

Plaka kontrabandiste

Gjatë një kontrolli jo edhe aq routine në aeroportin e New Orleans, pasi siç dihet që pas atentatit të 11 shtatorit me shembjen e kullave binjake, kontrollet janë bërë më rigorozë, agjentët e shërbimit të sigurimit ndaluan dhe vunë në pranga Stella Micchetti. Për të pranishmit ishte një arrestim vërtet i çuditshëm, pasi zonja në fjalë jo vetëm që ishte e moshuar, pasi i kishte kaluar të tetdhjetat, por ishte e paralizuar dhe lëvizte me karrocë paralitiku. E të gjithë ata që mendonin se mund të kishte ndonjë keqkuptim, u tërhoqën kur mësuuan se zonjës Micchetti iu gjetën një mori pilulash ecstasy. Ultra-tëdhjetëvjeçarja Micchetti që udhëtonte bashkë me të fejuarin e saj, 56-vjeçar, e pranoi se pilulat ishin të sajat, por kishte kujtuar se ato ishin... *viagra*.



Një hajdut Don zhuan

Kur Harry Grey, një spedicioner amerikan nga Dallas, në Texas u kthye në shtëpi pak më herët se zakonisht, pati fatin e mirë të kapte, si i thonë një fjalë, me presh në duar një hajdut që po mudohej të hapte kasafortën, në të cilën mbante, përveç parave, edhe objektet e çmuara. Pasi e lidhi njoftoi policinë. Në pritje që të vinin agjentët e ta merrnin Grey filloi të rërmonte nëpër xhapat hajdutit dhe shtang nga habia kur gjeti fotografinë e Nissia-s, që ishte gruaja e tij e ëmbël dhe shumë "besnike". E ktheu prapa fotografinë dhe pa në të të skicuar planimetrinë e shtëpisë së tyre. Gjithçka më pas u sqarua me ardhjen e agjentëve të policisë, të cilët morën në pyetje hajdutin. Pasi ishte bërë "mikeshë" e hajdutit, Nissia i kishte dhënë atij të planimetrinë e shtëpisë dhe vendin sekret kur ruanin paratë dhe pasi i dashuri i'i merrte të gjitha, do të braktiste të shoqin dhe të shkonte të jetonte me të.



Ha racionin ushqimin e peshkut, përfundon në spital

Mihai Stoleru, një peshkatar rreth të dyzetave rumun nga lasi, ndërsa po peshkonte si zakonisht ndjeu uri dhe menjëherë i shkoi mendja të ushqimi që e shoqja ia kishte përgatitur me aq dashuri e kujdes. Nxorri bukën nga çanta dhe hapi kavanozin me kapak të kuq, të cilin e përdorte gjithmonë për të futur gjellën që i përgatiste e shoqja, e cila këtë radhë kishte gabuar, pasi edhe ushqimin e peshqve, karrema e gjithçka tjetër përdoret për të gënjyer peshqit ia kishte futur në një kavanoz identik me atë të gjellës. I dhënë pas peshkimit, atij iu duk si diçka ekozitike "gjella" dhe e hëngri të gjithë. Por më vonë dhimbjet e forta në stomak e detyruan të lajmëronte ndihmën e shpejtë ku, në repartine urgjencës iu nënshtrua një lavazhi gastrik që e shpëtoi. Tani, sa herë që niset për të gjuajtur peshk, gjëja e parë që kontrollon është që ushqimi i tij dhe i peshkut të jenë në entetë ndryshme.



SUPER FJALEKRYQ

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18		
19			20		21			22		23		24						25		
26				27		28		29			30				31			32		
33				34			35					36		37	38			39		
40					41						42						43			
	44	45	46		47					48						49	50			
51			52		53			54			55				56			57		
58						59				60				61			62	63		
			64		65		66			67		68	69			70		71	72	
73		74			75	76				77		78			79		80		81	
82										84		85					86			87
88										89										91

- **HORIZONTAL**
- Fillojnë metodën.
 - Iniciale e Truffaut.
 - E famshme ajo e Kolombit.
 - Iniciale e Klee, piktor.
 - Mund të jetë okular.
 - Janë gazetat... si RD.
 - Një mund të jetë i integruar.
 - Ngrihet me... doli.
 - Fund janari.
 - Babaliu këngëtare.
 - Nazet pa kufij.
 - Merret me spiritizëm një i tillë.
 - Slita pa zë.
 - Në krye të armatës.
 - Ishin litaret e... Tarzanit.
 - Ishite ryma e Charles Baudelaire.
 - Janë shoferë të Formula 1.
 - Kaluar në krye.
 - Mbyllin një dyqan.
 - Nuk ka karagjozi.
 - Mbetur pa... frymë.
 - Loja me games.
 - Ernesto... Guevera.
 - Skandali që rrezoi Richard Nixon.
 - Mbyll romanin.
 - Lindin në kokë.
 - Mbahet për linjë.
 - Fillojnë makinacionet.
 - I kanë rrugët me... emra.
 - U shkrua nga Gorkij.
 - Shkruhet një për film.

- U shkrua nga Baudelaire.
- Gjysma tatimi.
- Iniciale e Rohmer regjisor.
- Kryeqyteti ku jemi.
- Qe miku i Eneas.
- Iniciale e Duvall.
- Një besnik me katër këmbë.
- Eshtë pomatë shëndeti.
- Eshtë lumë në Rusi.
- Të parat në atmosferë.
- Oliver regjisor.
- Spagna që këndon.
- Si sezonal.
- Ai i muzave ishte Helikona.
- Edith e La vie en rose.
- Nelson, ish-president i Afrikës së Jugut.

- Të famshme atgo Eleuzine.
 - Eshtë i palëvizshmi.
 - Janë klasat... që nuk takohen.
 - Një traktor me rrota.
 - Fillon për të zbardhur krimin.
- **VERTIKAL**
- Eshtë fjala e parë e bebes.
 - Brockovich e Julia Roberts.
 - Makina Panda.
 - Qendër fetare.
 - Ishin ministat e sulltanit.
 - Zakonisht janë në krye.
 - Eshtë pala që akuzon.
 - Një qeveritare mund të shikaktojë zgjedhje të parakohshme.
 - Në fund të pritjes.

- Në krye të shtetit.
- Ishte mali i muzave.
- Mbahen në skaje
- Fillojnë ideologjinë.
- Një mund të jetë lojgik.
- Eshtë e lehtë në meeting.
- Martin i Norma Rae.
- Ushtrohej nga bukanierët.
- Janë vende si... Monaco.
- Një mund të jetë shitjeje.
- Kanë shirit me... këngë.
- Janë biruca.
- Janë si njoftime.
- Mund të jenë tookë-tokë.
- Tase e volejbolli.
- Janë vende si katar.

- Kompozoi Cosi fan tutte.
- Fund filmi.
- Erjoni bomber.
- Janë si mantele.
- Qytet në Zvicër.
- Forum pa ekstreme.
- Neill aktor.
- Janë temperaturat më të ulëta.
- Ulet në dhomën e lartë.
- Gjysma e helmit.
- Një material inert.
- Drejtojnë fakultetin.
- Donna Summer.
- Ishin rapsodët e akejeve.
- Bëhet harku pa... hu.
- Carlos te Manchester City.
- Eshtë bosht.
- Ka rivale Mediaset.
- Mund të jetë mali.
- Jepet një për hartim.
- Ridimensionuar pjesërisht.
- Njofton nga Shqipëria.
- Dërgohet një me celular.
- Vala në stadium.
- Pak papastërti.
- Një pjesë e talenteve.
- Ritet pa kufij.
- Një fazë gjumi.
- Ektreme në panik.
- Unë dhe ti.
- Një metër në kufij.
- Fillojnë titrat.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHME

A	R	S	K	R	A	T	E	R	I	K	O	S	H	E	R	E	T	P	E	R	A	S		
G	A	B	R	I	E	L	E	A	T	M	O	S	F	E	R	A	A	K	O	R	D	I	M	I
R	M	A	R	A	M	S	T	R	M	O	S	F	E	R	H	I	B	E	R	N	I	A	M	
E	S	T	O	L	A	K	O	M	I	S	I	O	N	E	T	M	A	S	T	E	R	S	O	
S	P	E	N	E	P	E	R	I	M	E	T	R	A	T	K	K	I	S	E	P	N			
I	R	A	N	I	M	O	N	O	G	A	M	I	A	I	B	U	K	U	R	T	K	A	I	
O	N	A	T	E	L	I	N	J	T	A	T	A	K	I	M	E	T	O	T	I	L	A		
N	D	I	A	L	E	K	T	E	F	I	O	R	E	N	T	I	N	A	E	N	L			
I	B	A	N	D	O	N	E	O	N	O	P	R	T	J	E	T	E	R	K	T	A	P		
D	E	L	E	D	D	A	I	R	A	I	D	A	S	H	K	E	N	A	Z	I	T	E		
M	E	L	S	E	I	A	L	Z	E	R	A	T	K	A	A	L	A	M	E	T				
H	I	L	L	I	A	N	T	A	K	T	I	R	R	E	T	H	E	P	I	T	E	T		

HOROSKOPI

- Tani që Afërdita në shenjën tuaj është në një pozicion dominues sektori i dashurisë do të gëzojë një mbështetje të madhe dhe, nuk është çudi që të lindë ndonjë e re. Mirë shëndeti.
- Dashi**
Dëshironi të realizoni sa më shumë projekte, por mundësitë janë ato që janë, prandaj duhet të synoni në realimin e atij që paraqet më shumë interes për ju. Keni mbështetjen saturnit.
- Demi**
Ndoshta është mirë që me probleme kontratash e marrëveshjes të merren në një kompetent dhe i besuar i yti, pasi pikërisht është kjo pika e dobët. Afërdita më në fund "përkëdhel" erosit.
- Binjakët**
Edhe për ju, është Saturni ylli i mirë, i cili bën që peshorja tani të anojë nga ana juaj dhe me pak zgjuarsi i imponohet një kundërshtari tuaj. Me hënën në favor erosi nuk mund të jetë veçse pozitiv.
- Gaforja**
Me marsin në "opozitë" janë të tjerët ata që do ta shohin ndikimin e tij të agresivitetit tuaj, që herë herë mund të shoqërohet edhe me një farë arrogancë. Nga ana tjetër, Jupiteri ju sjell fat.
- Luani**
Kuađri juaj yjor duket disi i trazuar, pasi janë një sërë planetësh në kontrast, si Urani e Plutoni, "prapësia" e të cilëve sikur zbehet nga afrimi i Uranit. Në majë të gjuhes i keni ankimet!
- Virgjëresha**
Nëpërgjithësi kuađri yjor duket i qetë, por kjo nuk do të thotë se gjithçka do të shikohet vaj për ju. Saturni është në një pozicion që favorohet, por është Hëna që mund të sjellë sherr.
- Peshorja**
Edhe ju do të jeni në egjiden e një Saturni shumë pozitiv, i cili do t'ju mbështesë sidomos në aspektin profesional, ku edhe Merkur i do të luajë një rol të rëndësishëm. Mirë dashurie.
- Akrepi**
Sot do të jetë një ditë e qetë në përgjithësi, por do t'ju duhet të sqaroni një problem që prej shumë kohësh e keni lënë pas dore. Nxitimi është kretjesisht i pajustificueshëm.
- Shigjetari**
Do të jetë një ditë mjaft intensive përsa i përket aktivitetit tuaj që do të stimulohet nga dëshja Merkur-Uran, ndërsa Hëna favorizon kontaktet në planin sentimental dhe njoftjet e reja.
- Bricjapi**
Tani Afërdita në shenë është në një orbitë shumë harmonioze. Çka do të thotë se fusha sentimentale do të jetë më e privilegjuara. Kujdes nuk duhet të jetë shkëlqim në dërrasë të kalbur.
- Ujori**
Të lindurit e kësaj shenje, nën efektin e Saturnit do të jenë jo vetëm plon energji e dëshirë për të punuar, por edhe solidë në kontraste e përplasje të mundshme. Më të "butë" me partnerin.
- Peshqit**

LAJME
NGA BOTA

Shuhet fotografi
që ndryshoi botën

Horst Faas, një fotograf fitues i çmimeve të shumta ndërkombëtare për fotografië e tij në zona luftimi, ndërroi jetë ditën e mërkurë në moshën 79-vjeçare. Një shtetas gjerman, Faas u bashkua "Associated Press" në vitin 1956 dhe falë kurajës së tij të jashtëzakonshme, mbëriti në zona që askush më parë nuk kishte guxuar të shkonte, në luftë, revolucionet dhe Lojërat Olimpike. Mbi të gjitha, ai mbahet mend për mbulimin e luftës së Vietnamit, me imazhe që ndihmuan për të ndërgjegjësuar botën ndaj mizorive që po ndodhnin në vendin aziatik e duke kontribuar direkt në rivendosjen e paqes. Përkishtë për konfliktin e Vietnamit, ai fitoi edhe të parin midis dy çmimeve të tij prestigjiozë "Pulitzer".

Asnjë progres
për disidentin kinez

Disidenti i verbër kinez, i cili i shpëtoi arrestit në shtëpi duke u arratisur në ambasadën amerikane më parë gjatë muajit, deklaroi se nuk ka pasur ende asnjë progres në aplikimin e tij për t'u zhvendosur në SHBA. Përpara se Chen Guangcheng të largohet nga ambasada amerikane, duke hequr dorë edhe nga strehimi politik, atij iu premtua se do të kishte të drejtë të aplikonte lirish për të studiuar jashtë vendit. Një universitet amerikan i ka ofruar disidentit një bursë të plotë studimi dhe mundësinë për t'u zhvendosur në SHBA së bashku me familjen e tij, por deri më sot, asnjë zyrtar kinez nuk ka mbërritur në banesën e Guangcheng dhe asnjë formular nuk është plotësuar në lidhje me kërkesën e largimit të tij. Sipas informacioneve të "CNN", të gjitha formalitetet e zhvendosjes së tij në Universitetin e Nju Jorkut janë kompletuar, ndërsa pritet vetëm aprovimi përfundimtar i Pekinit zyrtar, në mënyrë që disidenti të largohet.

Hungaria ndryshon
ligjin për mediet

Qeveria hungareze ia ka dorëzuar parlamentit amendamentet për ligjin e diskutueshëm për mediet, të cilin Bashkimi Evropian e ka kritikuar rëndë, sepse, siç u vlerësua, pengon lirinë e gazetarëve. Vendimi u bë i ditur në faqen e internetit të parlamentit hungarez. Teksti, i nënshkruar nga ministri hungarez i Drejtësisë dhe Administratës, Tibor Navrács, sipas ndryshimeve në ligj, siguron mbrojtjen e burimeve të gazetarëve dhe zvogëlon kontrollin mbi mediet e shtypura. Në bazë të ligjit të diskutueshëm, i cili hyri në fuqi më 1 janar të 2011-ës, u formua Këshilli për Media, puna e të cilit punë ishte kontrollimi i të gjitha medieve hungareze.

Merr dritën jeshile pilula
që parandalon HIV-in

Një panel i Administratës për Ushqim dhe Barna i SHBA-së i ka dhënë pëlqimin barit të parë që thuhet se parandalon infektimin me HIV, duke hapur rrugën për një miratim historik në luftën kundër virusit që shkakton AIDS-in. Vendimi erdhi pasi pasoi provat klinike treguan se Truvada mund të ulë rrezikun e HIV-it te meshkujt homoseksualë nga 44 në 73 për qind, transmeton REL. Pilula e përditshme është për njerëzit e shëndetshëm që janë në rrezik të lartë të infektimit me HIV-it, duke përfshirë çiftet me një partner HIV-pozitiv. Truvada është përdorur që nga viti 2004 për të trajtuar njerëzit e infektuar. Ajo aktualisht shitet për 900 dollarë në muaj.

Brevik sulmohet
në gjykatë

Vëllai i një prej viktimave të Anders Behring Breivik lëshoi një këpucë në drejtëm të të pandehurit, duke ndërpërre seancën gjyqësore që po zhvillohej në kryeqytetin e Norvegjisë, Oslo. "Ti vrave vëllanë tim. Shkofsh në Djall", kllithi vëllai i viktimës, ndërsa po eskortohej jashtë gjykatës. Këpuca nuk goditi në shenjë, duke prekur avokatin mbrojtës në vend të vrasësit. 33-vjeçari Behring ka pranuar vrasjen e 69 personave në një kamp rinor në ishullin e Utojes dhe të tetë të tjerëve në një sulm me bombë në Oslo, në 22 korrik 2011. Megjithatë, ai mohon përgjegjësinë kriminale për masakrën e tij. Incidenti i ndodhur të premtën, fitoi quartroklije spontane nga antarë të tjerë të publikut në gjykatë. Dikush u dëgjua duke thirrur: "Bravo".



Bashkia Himare ju fton

Open 2012 Summer Season

12-13 Maj

NJË FUNDJAVË E MAGJISHME!!!

E SHTUNË
NRG Band / Flor Mumajesi / Elvana Gjata \ Klajdi Haruni \ Andy Gramm dhe shumë të tjerë!

E DIELË
Vëllezërit Korçarë / Animator / Parashuta / Alpinizëm / Zhytje / Ushqim tradicional.

Dhe më e rëndësishmja AKOMODIMI FALAS PËR TË GJITHË

Për më tepër informacion vizitoni
www.himara.gov.al

SPONSORIZUAR NGA:



MBESHTETUR NGA:



Alba Malltezi
Drejtores e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

Anila Basha
Drejtores e Shqiptarja.com
Arben Rrozhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Kronika: Elton Qyno

Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
Cel: +355696060418